



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 47/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.02.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Modifikimi i dokumentave të procedurës së procedurës konkurruese “E hapur, mbi kufirin monetar”, me objekt: “Për Hartimin, Ndërtimin, Financimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Transferimin e Terminalit të Transportit Publik Tiranë”, me nr. REF-64927-12-30-2016, me vlerë totale të vlerësuar të projektit 2.093.070.602 lekë (pa TVSH) ose 15.477.857,31 Euro (pa përfshirë TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.02.2014, nga autoriteti kontraktues Bashkia Tiranë”.

Ankimues:

“2 T” sh.p.k.
Rruga “Hasim Vokshi”, Nd. 14, h 4, Ap. 5, Tiranë

Autoriteti Kontraktues:

Bashkia e Tiranës
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, VKM nr. 575, datë 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me Koncesion/partneritet publik privat”, VKM nr. 469, datë 16.06.2010 “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e shqyrtimit të ankesave ndaj procedurave të koncesionit apo të vendimeve për përjashtim nga këto procedura”, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 27, datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:*Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë koncensionare dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat konkurruese, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 04.01.2014 është publikuar në portalin elektronik të prokurimeve, procedura konkurruese “E hapur, mbi kufirin monetar”, me objekt: “Për Hartimin, Ndërtimin, Financimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Transferimin e Terminalit të Transportit Publik Tiranë”, me nr. REF-64927-12-30-2016, me vlerë totale të vlerësuar të projektit 2.093.070.602 lekë (pa TVSH) ose 15.477.857,31 Euro (pa përfshirë TVSH).

II.2. Në datën 16.01.2014, operatori ekonomik ankimues “2 T” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar kriteret e kualifikimit e konkretisht:

[...]

Kundërshtimet tona lidhen me kriteret e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues, janë si më poshtë sqarojmë:

1. *Në pikën 1 të DK sqarohet se: Objekti i kontratës: “Për hartimin, ndërtimin, financimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e terminalit të transportit publik Tiranë”, AK fton operatorët ekonomikë në një procedurë ndërkombëtare tenderimi...*

Sa më sipër, lehtësisht vërehet se kjo procedurë është një procedurë ndërkombëtare ku lejohet pjesëmarrja e ofertuesve të huaj dhe paraqitja e një oferte prej tyre, çka nënkupton se në këtë procedurë koncension/partneriteti publik privat lejohet pjesëmarrja jo vetëm e ofertuesve të mundshëm të regjistruar në Republikën e Shqipërisë por edhe atyre të cilët operojnë dhe kanë seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Lejimi dhe ftesa për pjesëmarrjen e ofertuesve të huaj do të thotë përveçse lejimit të garimit të tyre në këtë procedurë dhe lehtësimin ose shmangien e kriterëve të cilat lidhen drejtëpërsëdrejti me kriteret/leje/licenca/vërtetime të cilat lëshohen vetëm në Republikën e Shqipërisë.

Referuar sa më sipër, është dhe vet AK, i cili nëpërmjet dokumentave të koncensionit/partneritetit publik privat, shtojca 9 Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit është sqaruar se në rastin e ofertuesve të huaj nëse në vendin e origjinës nuk lëshohet një dokument i kërkuar në kushtet e përgjithshme për kualifikim mjafton plotësimi i deklaratës ku të sqarohet se në vendin e origjinës nuk lëshohet një dokument i tillë.

Por vijimi më poshtë i kriterëve të kërkuara bie ndesh me këtë parim dhe atë të konkurrimit ndërkombëtar pasi në shtojcën 9 nga AK kërkohet dokumenta të cilat pengojnë konkurrencën e lirë, kriteret e cilat kufizojnë dhe përjashtojnë pjesëmarrjen e ofertuesve të huaj si më poshtë:

“Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës”.

Kërkimi i AK që për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale është diskriminues, pasi referuar VKM nr. 42, dt. 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, kërkohet që në rast të njësimit të licensës duhet regjistruar dega e shoqërisë së huaj në Shqipëri.

Pra të marrësh pjesë në procedurën e PPP-së si një ofertues i huaj duhet jo vetëm të hapësh degë në Shqipëri por dhe kesh kryer dhe njësimin e licensës. Akoma dhe më groteske bëhet përpjekja e AK kur kërkon përveç certifikatave ISO (të cilat në thelb garantojnë subjektet e tjera shtetërore ose private mbi cilësinë e shërbimit ose mallit që ofrohet) kërkohen edhe QKL të ndryshme të cilat jo vetëm nuk lëshohen në asnjë vend tjetër por kufizojnë haptazi pjesëmarrjen e ofertuesve të huaj në këtë procedurë. Siç do të sqarojmë më poshtë në një rast të kërkimit prej këtyre QKL-ve rezulton se ajo nuk ekziston me atë emër objekti të kërkuar, çka ngre dyshime serioze se ky kriter ka për qëllim pengimin e konkurrencës së lirë dhe avantazhimin e një ofertuesi në Republikën e Shqipërisë, për të cilin shprehemi më poshtë:

Ligji 125/2013 neni 1 “Qëllimi i këtij ligji është të krijojë një kuadër të favorshëm dhe të qëndrueshëm për nxitjen, thithjen dhe krijimin e lehtësive për investimet si koncensione/partneritete publike private.

Sa më sipër, me kriteret e përcaktuara në DK/PPP, AK nuk ka krijuar një klimë lehtësimi për investimet e huaja të cilat do të mundësonin realizimin e objektit të kontratës.

Neni 9 “Procedura për dhënien e koncensioneve/partneriteteve publike private zbatohet në përputhje me parimet e transparencës, mosdiskriminimit, proporcionalitetit, efikasitetit, trajtimit të barabartë, reciprocitetit dhe të sigurisë ligjore.

VKM nr. 575, datë 10.07.2013, neni 23....” Kriteret për dhënien e kontratës nuk duhet të jenë diskriminuese dhe duhet të jenë në përputhje me objektin e koncensionit”.

Sa më sipër AK me kërkesat e paraqitura nuk ka ndjekur parimet e mosdiskriminimit të ofertuesve të huaj, trajtimin e barabartë të tyre, përse kohë publikon një procedurë ndërkombëtare dhe vendos kushte/kritere të cilat janë të mundura për t’u plotësuar vetëm nga ofertues të regjistruar në Republikën e Shqipërisë.

- 2. Në pikën 3.2.2. nuk është sqaruar se për sa kohë (pra sa ditë) duhet të jetë i vlefshëm sigurimi i ofertës mbas përfundimit të mbarimit të vlefshmërisë së ofertave, çka rezulton të jetë lënë bosh, i paplotësuar.*

Neni 22, i ligjit 125/2013, përcakton: “Procedura për dhënien e koncensioneve/partneriteteve publike private, me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, bëhet në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Neni 49 i LPP përcakton: “Autoriteti kontraktues duhet të specifikojë në dokumentat e koncensionit/ppp çdo kërkesë për natyrën, formën vlerën dhe kushtet e tjera thelbësore të sigurimit të ofertës”.

VKM 914, datë 29.12.2014 “Ofertuesit ose kandidatët e kualifikuar duhet të paraqesin sigurimin e ofertës në vlerën 2% të vlerës limit të përcaktuar në dokumentat e koncensionit/ppp. Në dokumentat e koncensionit/ppp duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.

Sa më sipër AK duhet të përcaktojë periudhën e vlefshmërisë së ofertës bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës.

E njëjta problematikë vërehet dhe tek pika 3.4. ku sërish kohëzgjatja e vlefshmërisë së ofertave rezulton pa afat (e paplotësuar) pasi në kuptim të bazës ligjore të sipërcituar është e paqartë.

3. Gjithashtu në DK/PPP pika 4.2.1. është lënë e paplotësuar data e përfundimit të afatit për dorëzimin e ofertave dhe ora e saj.

Është detyrim i AK të saktësojë datën e përfundimit të afatit të dorëzimit të ofertave në çdo kapitull/nen/dispozitë të parashikuar në DK/PPP për të mos krijuar qartësi dhe konfuzion tek ofertuesit.

4. Në DK / PPP është parashikuar se:

Eksperiencë operationale dhe mirëmbajtjeje

Ofertuesi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme minimale:

(a) Operimin e një stacioni të transportit publik të një lloji dhe kompleksiteti të krahasueshëm me projektin e propozuar, të një lloji dhe kompleksiteti të krahasueshëm me shërbimet e propozuara, me rezultate të kënaqshme dhe të përfunduara prej tij si kontraktues kryesor, anëtar i një sipërmarrjeje të përbashkët, kontraktues menaxhues ose nënkontraktues, brenda pesë viteve të fundit.

1. Shërbime të ngjashme me objektin e Koncesionit/Partneritetit Publik Privat me vlerë 40% e vlerës së përllogaritur të shërbimeve të parashikuara në project dhe konkretisht: 300.000 (treqind mijë) Euro pa TVSH, të realizuara gjatë pesë viteve të fundit.

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me situacionet për shërbimet e kryera dhe vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plote dhe të suksesshëm të kësaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar.
- b) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatëse të shitjes (ku të shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara). me situacionet për shërbimet e kryera.

Sa më sipër kërkimin e AK e gjejmë në kundërshtim me ligjin, pasi referuar VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, neni 28 përcakton: "Autoriteti kontraktues si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Sa më sipër, kërkimi i AK ku kërkohet kontrata e shërbimit etj. janë të tepërta dhe në kundërshtim me dispozitën ligjore të sipërcituar. Referuar ligjit 125/2013 lidhur me specifikimet teknike në dokumentat e koncensionit/ppp kërkohet që AK ti referohen LPP VKM 914 datë 29.12.2014 është akti nënligjor i nxjerrë në zbatim të ligjit 9643, i cili ka për qëllim miratimin e rregullave për procedurat e konkurimit sipas fushave përkatëse.

Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht dhe vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetërore për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar ose me dokumenta ekuivalente me to.

Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, operatori ekonomik do të vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore përkatëse të shitjes (ku të shprehen qartë datat, shumat dhe shërbimet e realizuara). me situacionet për shërbimet e kryera.

Në asnjë rast specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë vetëm drejt një produkti/malli/shërbimi. Në hartimin e specifikimeve teknike autoriteti kontraktues duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementëve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar. Gjithashtu ligjvënësi ka parashikuar tre metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me referimin e standarteve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standarteve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standartizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standarteve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve. Metoda e dytë e hartimit të specifikimeve teknike lidhet me referimin e kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referosh standarteve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale. Gjithashtu edhe metoda e tretë e cila është një ndërthurje e dy metodave të mësipërme, por çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj". Autoritetet kontraktuese janë të detyruara të zbatojnë me përpikmëri dispozitën e mësipërme të LPP-së në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentat e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike) arrihet në përfundimin se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike autoriteti kontraktues të mundësojë një konkurim të drejtë të hapur dhe gjithëpërfshirës të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë.

[...]

Si rrjedhë në kushtet kur jemi përpara një procedure konkurrimi ndërkombëtare dhe në vende të ndryshme dokumentat e kërkuara lëshohen në forma të ndryshme kërkojmë ndryshimin e kriterit si më poshtë:

”Operimin e një stacioni të transportit publik të një lloji dhe kompleksiteti të krahasueshëm me projektin e propozuar, të një lloji dhe kompleksiteti të krahasueshëm me shërbimet e propozuara, me rezultate të kënaqshme dhe të përfunduara prej tij si kontraktues kryesor, anëtar i një sipërmarrjeje të përbashkët, kontraktues menaxhues ose nënkontraktues, brenda pesë viteve të fundit.

Shërbime të ngjashme me objektin e koncensionit/partneritetit publik privat me vlerë 40% e vlerës së përlogaritur të shërbimeve të parashikuara në projekt dhe konkretisht: 3000 (treqind mijë) euro pa TVSH, të realizuara gjatë pesë viteve të fundit.

5. *Në DK/PPP është parashikuar:*

Eksperiencë në Projektim

Ofertuesi ose një nënkontraktues i specializuar duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme minimale:

(a) *Xhiron mesatare vjetore si kontraktuesi kryesor, anëtar i një sipër-marrjeje të përbashkët, kontraktues menaxhues ose nënkontraktues (përkufizuar si faturim për punët rrugore në progres dhe të përfunduara) gjatë 5 (pesë) viteve të fundit prej 500.000 (pesëqind mijë) Euro*

(b) *përvojë të suksesshme si Kontraktues kryesor, anëtar sipërmarrjeje të përbashkët, kontraktues menaxhues ose nënkontraktues në projektimin e*

- të paktën një projekti dizanji me një vlerë 300.000 (treqind mijë) Euro pa TVSH; e realizuar pesë vitet e fundit ose

- projekte të shumta dizanji (prjektimi) me një vlerë 600,000 (gjashtëqind mijë) Euro pa TVSH , të realizuara pesë vitet e fundit

të një lloji dhe kompleksiteti të krahasueshëm me shërbimet e propozuara, me rezultate të kënaqshme dhe të përfunduara prej tij si kontraktues kryesor, anëtar i një sipërmarrjeje të përbashkët, kontraktues menaxhues ose nënkon-traktor, brenda pesë viteve të fundit.

Ligji 125/2013, neni 22: “procedura për dhënien e koncensioneve/partneriteteve publike private, me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, bëhet në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj”.

Ligji 9643, neni 61 përcakton “Autoriteti kontraktues në njoftimin e kontratës ose në dokumentat e koncensionit/ppp, u kërkon ofertueseve të tregojnë në ofertat e tyre, përqindjen e kontratës që ata mendojnë të nënkontraktajnë te palët e treta si dhe nënkontraktuesin e propozuar.

Kjo përqindje e caktuar për nënkontraktim duhet të jetë në përpjesëtim me vlerën e kontratës dhe nuk duhet të tejkalojë 40 për qind të vlerës së përgjithshme të kontratës.

Autoriteti kontraktues miraton nënkontraktuesët e mundshëm përpara lidhjes së nënkontratës me operatorin ekonomik fitues të kontratës, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, pa cënuar parimet e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni.

Dispozitat e këtij neni nuk prekin përgjegjësitë kryesore të operatorit ekonomik ndaj autoritetit kontraktues, për të cilin nënkontraktuesët mbeten palë e tretë, kundrejt marrëdhënies kontraktuale ndërmjet operatorit ekonomik dhe nënkontraktuesëve të tij/saj dhe duke e lënë operatorin ekonomik kryesor përgjegjës për zbatimin e të gjithë kontratës, pavarësisht se një pjesë e saj zbatohet nga nënkontraktuesët”.

Së pari, dispozitat e mësipërme nuk parashikojnë plotësimin e kushteve apo kritereve për nënkontraktuesin. Ligjvënësi me përcaktimet e mësipërme ka parashikuar mundësi që ofertuesi nëpërmjet vullnetit të tij një pjesë të punës/shërbimit ta nënkontrakttojë por kurrësi që nënkontraktuesi të përmbushë kritere në tender të cilat në thelb duhen përmbushur nga ofertuesi. Gjithashtu marrëveshja e nënkontraktuesit dhe ofertuesit më parë duhet miratuar nga AK me qëllim, lejimin e nënkontraktuesit për realizimin e shërbimit.

Referuar rëndësisë së kësaj objekt / kontrate, roli i projektuesit paraqitet i një rëndësie të veçantë duke patur në vëmendje përcaktimin /metodologjinë e përlllogaritjes dhe caktimin e fituesit, ku roli kryesor dhe rëndësia kryesore është hartimi i një projekti sa më të mirë, korrektësi teknike, standarti mjedisor etj.

Pra roli i projektuesit është i një rëndësie të veçantë dhe ligjërisht kërkesat për plotësimin e kritereve duhet ti referohen Ofertuesit e jo Nënkontraktuesit. Referuar frymës së ligjit, pasi ofertuesi plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara nga AK, ai me vullnetin e tij një pjesë të shërbimit mund ta nënkontrakttojë por kurrësi atributet dhe vlerësimi i ofertuesit (kualifikimi ose skualifikimi i tij) të bëhet nëpërmjet dokumentacionit të nënkontraktuesit. Rëndësi të veçantë ka dhe garantimi i AK mbi përmbushjen e detyrimit të projektuesit ofertues pasi referuar objektit të kontratës një ndër punët e kërkuara është dhe hartimi i projektit. Për çdo pakënaqësi, mospërmbushje detyrimi, AK ka përcaktuar dhe mjetet ligjore për sanksionimin e ofertuesit në rast të mospërmbushjes së detyrimeve, por në këtë rast AK nuk do të legjitimohej në asnjë kërkim apo pretendim që aim und të kishte ndaj nënkontraktuesit, pasi midis tyre nuk ka asnjë marrëdhënie juridike nga të cilat të lindin të drejta dhe detyrime.

Referuar sa më sipër sqaruar por dhe dispozitat të këtij ligji, kërkojmë ndryshimin e këtij kriteri si më poshtë:

“Ofertuesi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme minimale: [...]

6. Në DK/ PPP është parashikuar:

“Eksperiencë në Punime në infrastrukturë rrugore ose infrastrukturë Civile Përvojë të suksesshme në ekzekutimin e

1. Punë të ngjashme për një kontratë të vetme në infrastrukturën rrugore ose infrastrukturë civile me një vlerë jo më të vogël se 12.000.000 (dymbëdhjetë milion) Euro pa TVSH, e realizuar gjatë pesë vitet të fundit ose punë në vazhdimësi
 2. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku është në një vlerë prej 24.000.000 (njëzetë e katër milion) Euro pa TVSH, të realizuara pesë vitet e fundit ose punë në vazhdimësi
- Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme për punët e përfunduara

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Deklaratën sipas shtojcës Nr.7, shoqëruar me:
2. Kontratë
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Çertifikatën e marrjes në dorëzim.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 7, shoqëruar me:
2. Kontratë;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Akt kolaudimi objekti;
5. Çertifikatën e marrjes në dorëzim të objektit;
6. Fatura tatimore për çdo situacion punimesh.

Ligji 125/2013, neni 22[....]

VKM 575, dt. 10.07.2013, neni 23[...]

Bazuar në legjislacionin në fuqi, kërkesat e AK duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

Referuar objektit të kontratës ai rezulton “Hartim, ndërtim, operim, financim i terminalit të autobusëve”. Pra qartësisht kuptohet se në rastin e ndërtimit pjesa më e madhe e punës lidhet me punimet me natyrë civile të ngjashme me objektin e kontratës dhe jo rrugë.

Ndërtimi i rrugës hyrëse ose pjesëve të tjera të terminalit rezulton me një zë shumë të vogël krahasuar me atë të ndërtimit të objektit. Gjykojmë se kërkesë e AK “Punime në infrastrukturë rrugore”, është e tepërt dhe nuk është në përpjesëtim me natyrën e objektit”. Një ofertues i cili ka realizuar një kontratë të ngjashme me vlerën e kërkuar nga AK për punime rrugore nuk garanton dot se ka aftësi dhe kapacitetet e duhura për realizimin e kontratës pasi zërat kryesorë të punës objekt kontrate, janë lidhur me infrastrukturën civile (të cilat zënë dhe peshën kryesore

në këtë objekt kontrate). Pra AK nuk do mund të garantohej për përmbushjen e tyre me sukses pasi ofertuesi nuk do të mund të faktonte eksperiencën e tij. Ky pretendim i joni gjen mbështetje dhe nga vet kërkimi i AK në përcaktimin e kategorive dhe klasifikimit të pikave në licencë e zbatimit në ndërtim që duhet të ketë ofertuesi.

AK ka kërkuar që ofertuesi i mundshëm duhet të plotësojë kategoritë me klasifikimet si më poshtë:

NP – 2 F (Ndërtime Civile dhe industriale)

NP – 4 D (Rrugë, Autostrada, Ura etj,)

Klasifikimi (f) i kategorisë NP – 2 rezulton për vlera nga 401-800 milion lekë

Klasifikimi (d) i kategorisë NP – 4 rezulton për vlera nga 101-200 milion lekë.

Kërkesat e AK në përcaktimin e kategorive dhe klasifikimeve të pikëve në licencën e ndërtimit bazohen në studimin e fizibilitetit të hartuar nga AK. Pra dhe vetë AK nëpërmjet këtij kërkimi përcakton qartazi rëndësinë e ndërtimeve civile në raport me ato rrugore.

Referuar studimit të fizibilitetit si pjesë e dosjes së koncensionit/ppp, në kapitullin Llogaritja e Kostove dhe të Ardhurave dhe Analiza Ekonomike dhe Financiare ka parashikuar se:

Tabela -3 – Kostot e investimit për zgjidhjen 3 (vetëm ndërtimi)

PUNIMET KRYESORE	Njesi	m³	m²	Kosto perm³	Kosto perm³	Kosto per artikull	Porca punët ore në %	Total
Parkimi			2,200	€ 375				€ 825,000
Rruget			18,300	€ 73				€ 1,335,900
Parkimet dhe furnizimi me karburant			1,300	€ 350			30%	€ 455,000
strehat			17,000	€ 350				€ 5,950,000
Urat		3.360	727		€ 160		20%	€ 537,600
Dhoma teknike per kontrollin e pompave		350	117	€ 400			30%	€ 46,667

Ndarës i naftës/fluidit	no.	1				€		€ 42,000
						42.000		
Godinat e udhetareve			6	€ 1,100				€
								6.820.000
Ashensor per 8persona	no.	5				€ 35,000.		€ 175,000
TOTALI I PARKIMIT			40.247					€
								9,367,167

Pra referuar sa më sipër rezulton se kosto e parashikuar për rrugët është disa herë më pak se kriteri i vendosur nga AK. Për të mos harruar se AK lidhur me këtë pikë, pra eksperiencën e ofertuesit në punimet rrugore AK e kërkuar njëherë e konkretisht në pikën 2.3. Kapaciteti teknik të DK/PPP:

“Eksperiencë në Punime Rrugore

Përvojë të sukseshme në ekzekutimin e punë të ngjashme për një kontratë në infrastrukturën rrugore të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përlogaritur të projektit lidhur me infrastrukturën rrugore përkatësisht në vlerën 4.500.000 (katërmilion e pesëqind mijë) Euro pa TVSH, e realizuar pesë vitet e fundit ose

Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku është në një vlerë sa dyfishi i vlerës së përlogaritur të projektit lidhur me ndërtimin në infrastrukturën rrugore 18.000.000 (tetëmbëdhjetë milion) Euro pa TVSH, të realizuara pesë vitet e fundit.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme”.

Mendojmë se kriteri i mësipërm ka për qëllim favorizimin e subjekteve të cilën operojnë në fushën e infrastrukturës rrugore dhe me kërkimet e tij, AK po krijon avantazhe dhe kushte jo të barabarta konkurimi.

VKM nr. 575, datë 10.07.2013, neni 23[...]

Për sa më sipër kërkimin e AK e gjejmë tepër të pabazuar e si rrjedhojë kërkojmë ndryshimin e tij lidhur si më poshtë:

“Eksperiencë në Punime infrastrukturë Civile [...]”

7. Në DK/PPP është kërkuar se Vlerësimi i përvojës së suksesshme të operatorit ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme për punët në vazhdimësi:

- “Fatura tatimore derinë 30 ditë para datës së zhvillimit të procedurës
- Situacionet deri në 30 ditë para datës së zhvillimit të procedurës
- Vërtetim nga investitori për vlerën e realizuar deri në 30 ditë para datës së zhvillimit të procedurës

Ky kriter i vendosur bie ndesh me ligjin dhe është diskriminues. Është e paqartë dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të ligjit 125/2013; VKM nr. 575, datë 10.07.2013; Ligji nr. 9643, “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

Ligji 125/2013, neni 9[...].

Në referim të këtij neni e gjejmë këtë kriter diskriminues pasi nuk ka asnjë bazë ligjore, një kërkim i tillë i cili do të bënte të pavlefshme dokumentat ligjore, si dhe nuk bën një trajtim të barabartë midis ofertuesve.

Çfarë ndryshimi ka midis një subjekti i cili ka kryer një punë dhe e ka realizuar me sukses atë (pra shoqëruar me dokumentacionin përkatës 45 ditë përpara datës së hapjes së ofertave dhe një ofertuesi tjetër që ka kryer po të njëjtën punë ose shërbim të përfunduar me sukses 20 ditë përpara hapjes së ofertave?! Në këtë logjikë AK trajton në mënyrë të pabarabartë pjesëmarrësit duke u bazuar në një kriter preferencial e jo ligjor.

Neni 21[...]

Neni 22[...]

LPP – neni 20[...], neni 23[...].

VKM 575, datë 10.07.2013, neni 24, neni 23[...]

Referuar sa më sipër, kërkitimi i AK është më së paku diskriminues dhe ska asnjë bazë ligjore. Çdo faturë, situacion apo vërtetim nga investitori është i vlefshëm në çdo kohë dhe një kufizim i tillë nga AK është abuziv dhe ka për qëllim pengimin e konkurrencës së lirë duke patur parasysh kohën e afërt midis përfundimit të procedurës së parë të anuluar dhe procedurës së re të publikuar me dt. 04.10.2016.

Referuar këtij kriteri të vendosur ngrihen dyshime serioze, se ka për qëllim kufizimin e numrit të ofertuesve të mundshëm pasi është vetë AK kur ndërkohë parashikon se: “Eksperiencë në punime të infrastrukturë rrugore ose infrastrukturë civile Përvojë të suksesshme në ekzekutimin e Punë të ngjashme për një kontratë të vetme në infrastrukturën rrugore ose infrastrukturën civile me një vlerë jo më të vogël se 12.000.000 (dymbëdhjetë milion)Euro pa TVSH, të realizuara gjatë pesë viteve të fundit ose punë në vazhdimësi

Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku është në një vlerë prej 24.000.000 (njëzet e katër milion) Euro pa TVSH, të realizuara pesë vitet e fundit ose punë në vazhdimësi

Pra, atë kontraktues, njëherazi kërkon që këto dokumenta ose më saktë puna të jetë realizuar 30 ditë përpara datës së hapjes së ofertave dhe nga ana tjetër mundëson paraqitjen e dokumentave për punë të cilat janë në vazhdim cënuar në këtë mënyrë parimin e sigurisë juridike.

Sa më sipër, kërkojmë heqjen e kriterit të lartpërmendur.

8. Lidhur me pikën 2.2. Kapaciteti financiar

Kërkohet: “Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 5 (pesë) viteve të fundit ushtrimore (2011, 2012, 2013, 2014, 2015), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me AK Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar.

Së pari, referuar nenit 24 të VKM nr. 575, datë 10.07.2013 “Për të gjitha çështjet e njoftimit të kontratës, që nuk rregullohen nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, zbatohet ligji për prokurimin publik në përputhje me rrethanat.

Referuar ligjin 9643, neni 46/c, sqarohet se:

Gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur.

Referuar VKM 914, datë 29.12.2014...., kërkohet specifikisht që: kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse.

Pra lehtësisht vërehet se kërkesa e AK për dorëzimin e bilanceve të konfirmuara nga administrata tatimore është në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Më tej, kërkimi i AK shtrihet kur kërkohet që bilancet të jenë të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, një kërkim përsa poshtë sqarojmë në kundërshtim me dispozitat ligjore si më poshtë:

Bazuar në ligjin 10091, dt. 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, sqarohet se: Neni 1 Qëllimi dhe objektit

Ky ligj ka për qëllim përmirësimin dhe forcimin e mbikqyrjes publike të profesionit të audituesit ligjor, si dhe rregullimin e profesionit të kontabilistit të miratuar.

2. Ky ligj parashikon dispozitat që rregullojnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe të konsoliduara, organizimin e profesionit të audituesit ligjor të shoqërive të auditimit, të kontabilistit të miratuar, si dhe rregullimin e organizatave profesionale në fushën e kontabilitetit.

Neni 2 ... “Kontabilist i miratuar, është personi fizik, profesionist i lirë, i regjistruar në regjistrin e njërës prej organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar, që kontraktohet nga personi juridik për të kryer shërbime të kontabilitetit. Ai mund të kryejë edhe shërbime të tjera, të cilat nuk bien në kundërshtim me kërkesat e e legjislacionit në fuqi.

Neni 41 Personat juridike që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare[...]

Sa më sipër kërkimi i AK se bilancet duhet të jenë të audituara nga ekspertë të autorizuar është i kundraligjshëm e si rrjedhojë kërkohet ndryshimin e tij duke specifikuar se “të shoqëruara me auditimin ligjor në përputhje me ligjin 10091 dt. 05.03.2009” ose “të shoqëruara me auditim ligjor nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese”.

Sqarojmë AK se vendosja e termit ekspert kontabël i autorizuar është diskriminues dhe vlen vetëm në disa raste, kur auditimi kryhet për llogari të shoqërive të sigurimit ose bankave etj, çka ngre dyshime serioze se pikërisht vendosja e këtij kriteri për qëllime favorizimin e një ofertuesi i cili kryen një veprimtari të tillë.

Autoriteti kontraktues në hartimin e specifikimeve teknike krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit duhet të ketë në vëmendje faktin se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përpuethshmëri me objektin e kontratës. Një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Specifikimet teknike duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë /përrjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertue dhe/ose prodhuesit qofshin këto kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktuese duhet të shmangin çdo formë diskriminimi qoftë ato të dukshme qoftë ato të fshehta të cilat kanë të njëjtin efekt[....]

Sa më sipër kërkohet ndryshimin e këtij kriteri si më poshtë:

“Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 5 (pesë) viteve të fundit ushtrimore (2011, 2012, 013,

2014, 2015), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të shoqëruara me auditimin ligjor në përputhje me ligjin 10 091 dt. 05.03.2009”.

Ose

“Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 5 (pesë) viteve të fundit ushtrimore (2011, 2012, 2013, 2014, 2015), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të shoqëruara me auditim ligjor nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese”.

Lejimi dhe ftesa për pjesëmarrjen e ofertuesve të huaj do të thotë përveçse lejimit të garimit të tyre në këtë procedurë dhe lehtësimin ose shmangien e kriterëve të cilat lidhen drejtëpërsëdrejti me kriteret/leje/licenca/vërtetime të cilat lëshohen vetëm në Republikën e Shqipërisë.

Sa më sipër, kërkojmë gjithashtu që të shtohet një paragraf ku të sqarohet se:

“Për ofertuesit e huaj të paraqiten dokumentat e mësipërme në përputhje me legjislacionin në vendin e origjinës”.

9. Në lidhje me pikën 2.3. Kapaciteti teknike i ofertuesit, në pikën a (Eksperiencë në ndërtim), në pikën b Eksperiencë në punime rrugore në fund të tyre është sqaruar se:

Pika 3 plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 4 duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Së pari, sqarojmë se procedura e partneritetit publik privat është një procedurë komplekse e cila realizohet nëpërmjet burimeve të financimit të vet ofertuesit pjesëmarrës dhe realizimin e veprës po me mjetet dhe kapacitetet e tij.

Sa më sipër referuar kërkimin tuaj, nëse një shoqëri bankare ose institucion financiar kërkon të angazhojë fondet e saj në bashkëpunimin me një shoqëri ndërtimi për realizimin e veprës, ky bashkim do të ishte i pamundur pasi referuar kërkimin tuaj, edhe vetë institucioni financiar duhet të ketë eksperiencë në ndërtim në aq përqind sa do të marrë pjesë në bashkim. Një absurditet i cili në gjykimin tonë ka për qëllim favorizimin e një subjekti në Republikën e Shqipërisë pasi siç vërehet lehtësisht ky kriter nuk është parashikuar në pikën C. Është e paqartë se përse pikërisht ky kërkim është vetëm për pjesën e ndërtimit dhe tek pjesa e eksperiencës operacionale mungon një kërkim i tillë?!

Më së paku ky është një standart i dyzuar prandaj kërkojmë heqjen e tij. përse duhet të vendoset një kusht i tillë vetëm për pjesën e ndërtimit? Mbi çbazë ligjore është referuar AK në përcaktimin e këtij kriteri pasi ligji në fuqi e ka të shprehur shumë qartë dhe nuk krijon ndasi midis punëve ose shërbimit.

Arsyetimi i mësipërm i referohet nenit 26 të VKM 914, datë 29.12.2014.... Nuk jemi në rastet e procedurave të koncensionit/ppp, por koncension/ppp ku konsorciumi ofertues përbëhet nga shoqëri projektuese, IT, shoqëri që kanë eksperiencë në mirëmbajtje operationale (terminalesh) dhe shoqëri ndërtimi. Si mund të plotësojë shoqëria e IT (e nevojshme për zgjidhjen e IT apo e projektimit kushtin e mësipërm për eksperiencë në ndërtim rrugësh apo ndërtime civile?

Kjo bie në kundërshtim me nenin 25 të VKM 575 e cila përcakton se Çdo operator ekonomik duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në legjislacionin në fuqi dhe ato të përcaktuara në dokumentat e koncensionit/ppp “Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë grupi, i marrë së bashku në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë/shërbim të përcaktuara në aktmarrëveshje.

10. Lidhur me kërkimin e AK mbi Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt (drejtuesi teknik duhet të ketë mbi 20 (njëzet) vjet eksperiencë pune e pasqyruar kjo në librezën e punës). Gjykojmë se ky kriter i AK është i ekzagjeruar pasi eksperiencia e kërkuar është e tepërt dhe ska asnjë bazë ligjore.

Së pari, referuar neni 24 të VKM nr. 575, datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat:

Për të gjitha çështjet e njoftimit të kontratës, që nuk rregullohen nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij zbatohet ligji për prokurimin publik në përputhje me rrethanat.

VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 26, Kontrata e Punëve:

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktues kërkon:

- Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit*

VKM ne. 575 datë 10.07.2013, neni 23[...]

Sa më sipër kërkit i AK është i tepërt dhe nuk është në përpjesëtim me kërkesat e tjera të përcaktuara në DK/PPP ku referuar kërkit për eksperiencën e ngjashme kërkohet të 5 viteve të fundit.

Si rrjedhojë kërkojmë ndryshimin e kriterit si më poshtë:

“Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin teknik të punimeve në objekt (drejtuesi teknik duhet të ketë mbi 5 (pesë) vjet eksperiencë pune e pasqyruar kjo në librezën e punës ose me dokumentat ekuivalent).

Duhet të nënvizojmë se në të gjithë vendet e bashkimit europian dhe në SHBA, librezat e punës e individit është një e dhënë tepër konfidenciale, pasi përmban të dhëna sekrete si pagesa e individëve ndër vite e aq më tepër e stafit teknik (inxhinierëve). Duke qenë të dhëna sensitive, ligjet e shteteve të origjinës e ndalojnë publikimin e saj. Shoqëria jonë kupton se qëllimi i kërkesës së autoritetit kontraktues është të provohet eksperiencia e drejtuesit teknik, por duke marrë shkas që procedura e mësipërme e koncensionit/PPP është e hapur ndërkombëtare dhe si e tillë nuk mund të diskriminohen subjektet e huaja dhe të avantazhohen ato vendase, kërkojmë që të ndryshohet kriteri i mësipërm dhe të

pranohet edhe çdo dokumentacion ekuivalent i njohur nga shteti i origjinës me anë të së cilit provohet eksperiencia e drejtuesit teknik.

11. AK ka kërkuar një punësim mesatar prej 300 punonjësish për periudhën Janar 2014 – Dhjetor 2016.

Një kërkim ky i çmuar nga AK si i nevojshëm për t'u njohur mbi kapacitetet e ofertuesit pjesëmarrës. Por ajo çka bën ngre dyshime është pikërisht kërkitimi tjetër i AK kur kërkon që inxhinierët e kërkuar të figurojnë prej periudhës Janar 2015 – Dhjetor 2016 ?????.

Pra lehtësisht vërehet se kemi një mospërputhje me kërkitimet e AK.

Akoma më abuzive bëhet përpjekja kur kërkohet që mjeku të figurojë për periudhën Dhjetor 2014 – Dhjetor 2016.

Pra është tepër e dyshimtë ndryshimet në kërkitimet e AK referuar kohës së tyre, çka ngre dyshime serioze se këto kërkitime kanë për qëllim favorizimin e një subjekti në Republikën e Shqipërisë pasi në dijeninë tonë këto kritere plotësohen pikërisht nga ky i fundit.

VKM nr. 575, datë 10.07.2013, neni 23[...]

Sa më sipër, kërkojmë ndryshimin e kritereve të lartëpërmendura duke barazuar kohën e kërkitimit të tyre.

[...]

Gjithashtu, në rastin konkret, mendojmë se parashikimi i mësipërm në lidhje me dorëzimin e List Pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 201- Dhjetor 2016 shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore është një kriter diskriminues duke avantazhuar haptazi operatorët shqiptarë. Së pari, duhet të theksojmë se listëpagesat janë konfidenciale (i përkasin shoqërisë) dhe përmbajnë të dhëna tregtare mbi pagesat e personelit, të cilat nuk i interesojnë autoritetit kontraktues në momentin e parakualifikimit. Përse kërkohen listëpagesat e dy viteve, ku të pasqyrohen të treqind punonjësit, pagat e tyre, kur autoriteti kontraktues farë mirë mund të kërkojë vërtetime se ekspertët si (inxhinierët, specialistët e çertifikuar të cilët janë kërkuar të figurojnë në listëpagesav për periudhën e kërkuar. Pra sa më sipër, duke menduar se paraqitja e listëpagesave për të gjithë periudhën e kërkuar nuk ndikon aspak në vlerësimin e kapaciteteve teknike, pasi informacioni mbi dëshminë e fuqisë punëtore merret me anë të vërtetimit, atëherë kërkojmë që ky kriter të hiqet. Madje, kërkesa për dorëzimin e formularëve të pagimit të detyrimeve shoqërore dhe shëndetësore është një kërkesë që i referohet ligjit shqiptar, pasi në vendet e huaja për kompani ndërkombëtare, një informacion i tillë nuk aplikohet por me anë të vërtetimeve të ndryshme lëshuar nga administrata tatimore të kërkuara në Kriteret e Përgjithshme të pranimit merret informacion mbi shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në vendet e origjinës.

12. Në DK është kërkuar, të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në listëpagesa për gjashtë muajt e fundit të paktën 30 punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT. Sqarojmë se një kërkim i tillë është i tepërt pasi pikërisht për këtë qëllim nga ofertuesi kërkohen certifikata ISO. Është e paqartë se çfarë vlere provuese ka një kërkim i tillë për kapacitetin e shoqërisë?? Kërkojmë heqjen e këtij kriteri pasi më së paku është diskriminues. Çfarë vlere ka më shumë provuese një IQT e një saldatori se një certifikatë ISO e cila ka si objekti garantimin mbi standartet profesionale për saldim të shoqërisë? Siç vërehet edhe ky kriter ka për qëllim pengimin e konkurrencës së lirë.
[...]

Në nenin 9 pika 1 gërma "a" të ligjit nr. 8734 datë 01.02.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike", parashikohet se "Formimi i punëmarrësve" Punëdhënësi merr masat e nevojshme që: a) përdorimi i pajisjeve elektrike të bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, e lëshuar nga IPIE-ja ose nga komisioni i miratuar prej saj". Në nenin 7 të ligjit nr. 13/2013 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8734 datë 01.02.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike", parashikohet se "Në nenin 9, shkronja "a" e pikës 1 ndryshohet si më poshtë: "a) Përdorimi i pajisjeve elektrike bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, të lëshuar nga një organ i akredituar certifikues personeli për fushën përkatëse".

Gjithashtu në nenin 5 pika 1 gërma "c" të ligjit nr. 116/2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë", parashikohet se: "Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit akrediton: c) organe certifikuese të personelit". Konstatohet se referuar ndryshimeve të lex specialis ligjit nr. 8734 datë 01.02.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike" me anë të ligjit nr. 13/2013 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike", parashikohet se Përdorimi i pajisjeve elektrike bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme të dokumentuar me dëshmi aftësie, të lëshuar nga një organ i akredituar certifikues personeli për fushën përkatëse". Sa më sipër gjykojmë se kuadri ligjor në fuqi nuk parashikon mundësinë e certifikimit të punonjësve të subjekteve juridike pranë një organi shtetëror (ish Inspektoriati Qendror Teknik IQT) sot Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI).

Përse pikërisht ai numër punonjësish me grupet e mësipërme të kategorive? Përse duhen 30 punonjës me dëshmi aftësimi profesional për punime elektrike? Kemi të bëjmë me ndërtime civil dhe jo me rikonstruksion linjë elektrike. Gjithashtu kërkojmë të shtohet termi ekuivalent për dokumentat e paraqitura nga shoqëritë e huaja.

13. Licencë kodi III.7 A. Shërbime profesionale për projekttime, shërbime profesionale për zbatime.

Referuar Rregullores nr. 3, datë 08.07.2009, ligjit nr. 9385 datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimit Pyjor” dhe VKM nr. 538 datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta, si dhe faqes zyrtare të QKL-së rezulton se kjo leje ka si objekt licencë për shërbime të ekspertizës dhe ose profesionale lidhur me pyje apo kullota.

Më poshtë po ju ilustruam me figurë sesi rezulton në faqen zyrtare të QKL-së një licencë e tillë me këtë kod.

[...]

Pra sa më sipër, rezulton se kërkimi i AK është në kundërshtim mesa në sipër. Ndër të tjera ju sqarojmë se një kërkim i tillë nuk është në përputhje dhe përpjesëtim me natyrën e objektit të kontratës pasi ndërtimi i këtij objekti do të kryhet mbi tokë truall referuar dhe sqarime të AK. Pra çfarë vlere provuese ka një licencë e tillë për AK në një kohë që nuk jemi përpara kushte të punës përse i përket këtij lloji licensimi.

VKM nr. 575, datë 10.07.2012, neni 23[...]

14. Është kërkuar: Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

Referuar dispozitave të K. Civil kontrata ka fuqinë e ligjit për palët dhe kërkimi i AK që duhen noteriale është i pakuptimtë pasi K. Civil e ka rregulluar qartësisht se në cilat raste duhet kontrata noteriale. Një kontratë e vlefshme për periudhën e ndërtimit por që nuk noteriale nuk do të thotë se nuk ka fuqi ligjore apo nuk përmban të drejta dhe detyrime për palët. AK duhet të sqarojë se përse një kërkim i tillë është vendosur kur bie ndesh me ligjin dhe K.Civil.

Kërkojmë ndryshimin e këtij kriteri si më poshtë:

Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse në përputhje me K.Civil ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

15. Në DK rezulton se: (e detyrueshme) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në 10 ditë para zhvillimit të procedurës së Konkensionit të Partneritetit Publik Privat në mënyrë të tillë që operatorët ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t’u jepen informacione shitesë e shpjegime. Të gjitha kostot e operatorëve ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t’a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.

Është e paqartë nëse është kriter skualifikues ose pjesëmarrja në kantier?! Sqarojmë se edhe në praktikat tashmë të konsoliduara në KPP vizita në kantier nuk duhet dhe nuk mund të jetë detyruese por ajo vlen vetëm për sqarime dhe informacione të tjera që ofertuesi mund të çmojë të nevojshme.

16. Në DK/PPP është kërkuar që për të provuar eksperiencën e ngjashme në ndërtim duhet të paraqiten dokumentat si më poshtë:

Për kontratat e realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Deklaratë sipas shtojcës nr. 7, shoqëruar me:

2. Kontratë

3. Situacion përfundimtar

4. Aktin e kolaudit

5. Çertifikatën e marrjes në dorëzim

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Deklaratë sipas shtojcës nr. 7, shoqëruar me:

2. Kontratë

3. Situacion përfundimtar

4. Aktin kolaudit objekti

5. Çertifikatën e marrjes në dorëzim të objektit

6. Faturë tatimore për çdo situacion punimesh

Në hartimin e specifikimeve teknike autoriteti kontraktues duhet të mbajë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar.[...]

Sa më sipër, gjendur në përpara kushteve kur në shtete të ndryshme nuk lëshohen dokumenta si shtojca nr. 7 e kërkuar sa më sipër, lidhur me kërkimet e AK për të provuar eksperiencën e ngjashme në ndërtim duhet të shtohet:

“Për ofertuesit e huaj, në rast të moslëshimit të dokumentave si më lart, të paraqiten dokumenta ekuivalente me to”.

17. Në DK/PPP është kërkuar:

Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2016.

Në rradhë të parë, ritheksojmë se kemi të bëjmë me një tender ndërkombëtar, të hapur, me një kohëzgjatje kontrate 35 vjet. Kriteret e mësipërme diskriminojnë ofertuesit e huaj dhe favorizojnë vetëm ofertuesit vendas, ku vetë AK është e bindur se këtë sipërmarrje

prej 15 milion eurosh mund ta marrë vetëm një konsorcium mes kompanive shqiptare dhe të huaja. Kërkesa për dorëzimin e vërtetimeve të shlyerjes së taksave për pushtetin lokal të vitit 2016 është një kriter i cili nuk është në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës. Në shumë vende të Bashkimit Europian, taksat lokale dhe kombëtare menaxhohen nga një administratë e vetme. Gjithashtu nuk është i njëjti ligj si në RSH.

Ndodhur në këto kushte kur kjo rezulton një procedurë ndërkombëtare, kërkojmë të hiqet si kriter, ose së paku të shtohet: “Për ofertuesit e huaj, në rast të moslëshimit të këtij dokumenti në vendin e origjinës, të paraqitet dokument ekuivalent me të ose deklaratë me shkrim”.

18. Bazuar në legjislacionin në fuqi, konkretisht në ligjin 125/2013, neni 22 “Procedura për dhënien e koncensioneve/partneriteteve publike private, me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, bëhet në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në ligj”.

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 është akti nënligjor i nxjerrë në zbatim të ligjit nr. 9643, i cili ka për qëllim miratimin e rregullave për procedurat e konkurrimit sipas fushave përkatëse. Referuar neneve 26, 27, 28 në kërkesat e AK është detyrim ligjor kërkimi lidhur me shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike

Sa më sipër, kërkojmë të shtohet në DK/PPP kërkimi si më poshtë:

“Një çertifikatë që konfirmon pagesën e të gjitha detyrimeve të maturimit të kontratave të energjisë elektrike të operatorëve ekonomikë, regjistruar në Shqipëri. Mospagesa e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për përjashtimin e operatorëve ekonomikë, nëse rezulton që detyrimet e papaguara të energjisë elektrike siç konfirmohet nga çertifikata e lëshuar nga furnizuesi janë në procesin e ankimimit në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar të lëshojë këtë çertifikatë jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e paraqitjes së operatorëve ekonomikë.

Për ofertuesit e huaj nëse ky dokument nuk lëshohet në vendin e origjinës të lëshohet një deklaratë me shkrim.

19. Në DK/PPP është kërkuar: Për inxhinierët dhe stafin teknik drejtues dhe jo drejtues dokumentacioni si më poshtë:

i. Librezë pune (përkatëse)

ii. CV përkatëse

iii. Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)

iv. Diplomë

Ndodhur në kushtet kur kjo rezulton një procedurë ndërkombëtare, kërkojmë të shtohet:

“Për ofertuesit e huaj, në rast të moslëshimit të ndonjë prej këtyre dokumentave në vendin e origjinës, të paraqitet dokument ekuivalent me të ose deklaratë me shkrim”.

20. Në DK/PPP është kërkuar që shoqëria për të vërtetuar marrëdhënien e punës me punëmarrës të ndryshëm si inxhinier etj, kërkon:

Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2014 – Dhjetor 2016 shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Ndodhur në kushtet kur kjo rezulton një procedurë ndërkombëtare kërkojmë të shtohet:

“Për ofertuesit e huaj, në rast të moslëshimit të ndonjë prej këtyre dokumentave në vendin e origjinës, të paraqitet dokument ekuivalent me të”.

[...]

21. Në DK/PPP është kërkuar:

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) mjek ndërmarrjeje, kjo të vërtetohet me paraqitjen Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe Kontratës së punës së mjekut me operatorin ekonomik e vlefshme për periudhën e ndërtimit dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën dy vitet e fundit, përkatësisht periudhën Dhjetor 2014 – Dhjetor 2016. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë të paktën anëtari kryesor i bashkimit duhet të plotësojë këtë kusht të ketë 1 mjek ndërmarrjeje.

Ky vendim i AK është në mbështetje të Vendimit nr. 692, datë 13.12.2001, ndryshuar me VKM nr. 742, 6.11.2003, e cila ka fuqi ligjore vetëm për shoqëritë që operojnë në RSH.4sa më sipër kërkojmë të specifikohet në DK/PPP se në rast të ofertuesve të huaj ky kriter rregullohet sipas legjislacionit në vendin e origjinës.

22. Në DK/PPP është sqaruar se:

Nr.	Kriteri	Rezultati Maks.	Pragu Min/ Rezult. Kalues
TC1	Përputhshmëria me Kriteret Minimale Teknike	2	1
TC2	Korrektësia teknike dhe operacionale	34	20
TC3	Sistemet e informacionit	4	2

TC4	Pranueshmëria Mjedisore dhe Sociale	10	
TC4-1	- siguria e brendshme e zonës dhe ndërtesave	4	
TC4-2	- teknikat inovative në fushën e kursimit të energjisë dhe pajtueshmëria me standardet mjedisore	4	
TC4-3	- zvogëlimi i ndikimit mbi trafikun lokal gjatë aktiviteteve të ndërtimit	2	
	KRITERET TOTALE TEKNIKE	50	
FC1	KOHËZGJATJA E KONÇESIONIT	10	
FC2	TARIFA E KONÇESIONIT	10	
FC3	TARIFAT E TERMINALIT	10	
FC4	NDARJA E FITIMIT	10	
	KRITERET TOTALE FINANCIARE	40	
CTC1	AFATI I NDËRTIMIT	10	
	TOTALI	100	

Sa më sipër, rezulton se për N. TC1, TC2, TC3, përveçse është specifikuar pikët për secilën kategori, është vendosur dhe Pragu minimal i pikëve për kualifikim. Sqarojmë se hartimi i projektit duhet të kryhet nga ofertuesi bazuar në të dhënat dhe përcaktimet e AK. Vlerësimi i tyre është subjektiv në varësi të gjykimit të tyre, mbi pritshmëritë e tyre, por kurrsesi një vlerësim subjektiv nuk mund të përbëjë shkak për skualifikimin e ofertuesit.

Pretendimi jonë gjen mbështetje në ligjin 125/2013, neni 23 [...]

Sa më sipër, gjukojmë se ligjvënësi ka krijuar hapësirat e nevojshme ligjore për vlerësimin e projekteve por në asnjë rast gjykimi subjektiv të përbëjë shkak për përjashtimin e ofertave vetëm e vetëm pse ai nuk përmbush pritshmëritë e anëtarëve të Komisionit. Në këtë rast se atyre ju lind e drejta ta vlerësojnë atë me pikë minimale. Sa më sipër kërkojmë heqjen e pragut minimal për t'u kualifikuar dhe saktësimin e tij me pragu minimal i pikëzimit.

23. Në DK/PPP është kërkuar:

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë pjesë të stafit teknik të punësuar të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV dhe të figurojnë në listëpagesa për periudhën Janar 2015 – Dhjetor 2016

- Inxhinier Ndërtimi (4)
- Inxhinier Topograf (2)
- Inxhinier Elektrik (1)
- Inxhinier Elektronik (3)
- Inxhinier Mekanik (2)
- Inxhinier Mjedisi (1)
- Inxhinier Informatik (1)
- Inxhinier Hidroteknik (1)

Ligji 125/2013, Neni 1[...]

VKM nr. 575, datë 10.07.2013, neni 23 [...]

Autoriteti kontraktues në hartimin e kriterëve të koncensionit/ppp bazohet në objektin e prokurimit dhe nevojën e stafit që kërkohet për realizimin me sukses të veprës.

Vlerat dhe volumet e punimeve janë parashikuar nga AK e konkretisht në Studimin e Fizibilitetit si më poshtë:

Tabela -3 – Kostot e investimit për zgjidhjen 3 (vetëm ndërtimi)

PUNIMET KRYESORE	Njesi	m ³	m ²	Kosto perm ³	Kosto perm ³	Kosto per artikul	Forca punët ore në %	Total
Parkimi			2,200	€ 375				€ 825,000
Rruget			18,300	€ 73				€ 1,335,900
Parkimet dhe furnizimi me karburant			1,300	€ 350			30%	€ 455,000
strehat			17,000	€ 350				€ 5,950,000
Urat		3.360	727		€ 160		20%	€ 537,600

Dhoma teknike per kontrollin e pompave		350	117	€ 400			30%	€ 46,667
Ndarës i naftës/fluidit	no.	1				€ 42.000		€ 42,000
Godinat e udhetareve			6	€ 1,100				€ 6.820.000
Ashensor per 8persona	no.	5				€ 35,000.		€ 175,000
TOTALI I PARKIMIT			40.247					€ 9,367,167

Zbutje mjedisore:								
Peme	no.	485				€ 200		€ 97,000
Bar			47,400	€ 1.2				€ 56,880
Punime për sistemin e kullimit	no.	1				€ 33,000		€ 33,000
Zona gjelber punime ndertimore			38,000			€ 40		€ 1,520,000
Prishje ndërtesa dhe gjermim dheu		200	400	€ 180			10%	€ 72,000
Shkalle levizese	no.	6				€ 57,500		€ 345,000
Ashensor per 5 persona	no.	10				€ 22,000		€ 220,000
Hapsira publike			4,000	€ 55				€ 220,000

SHPENZIME TË PËRBASHKËTA								€ 2,563,880
TOTAL								€ 11,931,047

Referuar kërkit të AK dhe vlerave të punimeve e gjejmë të pabazuar kërkitin e AK dhe jo në përpjesëtim të drejtë me zërat dhe volumet e punimeve kërkitin për:

- Inxhinier Ndërtimi (4)
- Inxhinier Elektronik (3)
- Inxhinier Informatik (1)

Në rastin e punimeve të inxhinierisë mjedisore AK ka kërkuar vetëm një inxhinier edhe pse volumi i punimeve zë afërsisht 3 milion euro punime ndërsa për një zë i cili zë më pak se 47.000 euro kërkon që ofertuesi të ketë 3 inxhinierë elektronikë.

....

Referuar kritereve të përcaktuara gjykojmë se këto kritere kanë për qëllim favorizimin e një ofertuesi në RSH dhe pengimin/kufizimin e ofertuesve të tjerë pjesëmarrës duke krijuar pengesa të drejtëpërdrejta për pjesëmarrjen e tyre.

Sa më sipër gjykojmë se kriteri i vendosur duhet ndryshuar si më poshtë:

- Inxhinier Elektronik (1)

25. Në DK/PPP është kërkuar:

Licencë III 1.A Lejë mjedisi tipi C. Pikë shërbimi për riparim automjetesh

[...]

VKM nr. 575, neni 23, 24[...]

Sa më sipër nga AK nuk është kërkuar dhe ska lidhje me objektin e kontratës një kërkitin i tillë. Sa më sipër kërkojmë heqjen e këtij kriteri.

25. Në APP është ngarkuar një kërkesë nga një shoqëri e cila ka kërkuar sqarime nga AK ku ndër të tjera e vë në dijeni se ka një mospërputhje midis dy dokumentave standarte, pra atij në gjuhën shqipe dhe atij në gjuhën angleze.

Kërkesa për sqarim ka për qëllim vetëm informimin dhe sqarimin dhe jo ndryshimin e kritereve të koncensionit/ppp. AK në shkelje flagrante të ligjit ka ndryshuar kriterin e përcaktuar në DK/PPP shqip dhe nuk ka respektuar detyrimin e tij ligjor për shtyrjen e datës së dorëzimit të

ofertave. Gjithashtu AK në përgjigje të kërkesës së kësaj shoqërie ka sqaruar se prevalon DK/PPP në gjuhën angleze.

Referuar Kushtetutës së Shqipërisë gjuha zyrtare është gjuha shqipe. Referuar të gjitha procedurave, praktikat e deritanishme në çdo rast prevalon gjuha shqipe. Në të kundërt për të mos patur probleme lidhur me situata që mund të krijohen kërkojmë heqjen e dokumentave të DK/PPP në gjuhën shqipe.

Konkretisht paqartësia shfaqet si më poshtë vijon:

Tek DK/PPP në shqip tek pikat e licencës kërkohet:

NS-8A (Konstruksione betoni arme të parafabrikuar, struktura metalike dhe druri)

Ndërkohë tek DSPK në anglisht

NS-8A Prefabricated reinforced concrete, metal and wood structure constructions

Tek DK/PPP është kërkuar NS-9-C, tek DSPK në anglisht nuk është kërkuar.

26. Referuar DSPK autoriteti kontraktues ka parashikuar vlerën e buxhetit të projektit në monedhën Euro. Në nenin 20, pika 3 të ligjit 125/2013 parashikohet se: “Vlera e parashikuar e partneritetit publik privat llogaritet sipas përcaktimeve në legjislacionin e prokurimit publik”. Autoriteti kontraktues ka parashikuar vlerën e fondit limit në monedhën Euro, ku ndërkohë sipas nenit 9 pika 4 të VKM914 parashikohet se “Autoritetit kontraktues, në rastet e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë mund të konvertojë vlerën limit të kontratës me një monedhë ndërkombëtare të përzgjedhur prej tij sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën në të cilën dërgohet për publikim njoftimi i kontratës”. Kërkojmë të saktësohet DSK kursi i këmbimit apo data e kursit të këmbimit në lidhje me konvertimin e të gjithë vlerave të kërkuara në Euro. Kjo pasi, drejtëpërdrejtë pengon dhe krijon paqartësi për subjektet që kanë partner ndërkombëtarë të cilët, monedhën e vendit të tyre e kanë në USD apo në monedha të tjera.

Kërkojmë: Ndryshimin e kriterëve të Dokumentave të Konkensionit/Partneritetit Publik Privat.

II.5. Në datën 24.01.2014, nëpërmjet shkresës me nr. 2249/1 prot., datë 20.01.2014, me objekt: “Dërgim informacioni në lidhje me zhvillimin e procedurës së Konkensionit/Partneritetit Publik Privat me objekt “Për hartimin, ndërtimin, financimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e terminalit të transportit publik Tiranë”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktues lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimes.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktues,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi modifikimin e kriterit të përcaktuar në dokumentat e koncensionit/ppp: *“Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në dokumentat e koncensionit/ppp Shtojca 9 *Formular për vërtetimin e kualifikimit/pjesëmarrjes “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.4., është kërkuar:*

2.4 Licenca profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

a. Licenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- *NP – 1 D (Punime gërmimi në tokë)*
- *NP- 2 F (Ndertime civile dhe industriale)*
- *NP-3 C (Rindërtim dhe Mirëmbajtje e ndërtesave Civile dhe Industriale)*
- *NP-4D(Rrugë, Autostrada, Ura, etj.,*
- *NS-1C (Punime per prishjen e ndertimeve)*
- *NS-2B(Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanderi dhe mirëmbajtja e tyre)*
- *NS-3B(Impiante lëvizjeje dhe transporti (ashensorë, shkallë, lëvizës, transportues))*
- *NS – 4C (Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese)*
- *NS-5B(Implementim i sinjaleve me ndricim të trafikut)*
- *NS-6A(Sinjalistikë e pa ndriçuar rrugore)*
- *NS-7B(Barriera dhe Mbrojtje Rrugore)*
- *NS-8A(Konstruksione betoni arme të parafabrikuar, struktura metalike dhe druri)*
- *NS-9C(Punime të posaçme strukturore)*
- *NS-10B(Shtresa dhe struktura të veçanta)*
- *NS-12D(Instalime teknologjike, ngrohje dhe ajër i kondicionuar)*
- *NS-13C(Implementim i linjave telefonike dhe sistemeve të telekomunikacioni)*
- *NS-14D(Instalime të brendshme, elektrike, telefon, TV, etj)*
- *NS-19B(Sisteme izoluese të zhurmës për projektet infrastrukturore)*

sipas modelit të lëshuar nga MPPT;

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës”.

III.1.2. Në lidhje me kërkesën për njehsimin e licencës profesionale për operatorët e huaj pranë MPPTT, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se licenca profesionale e një operatori ekonomik të huaj ka të përcaktuar kategoritë si dhe përshkrimet përkatëse të tyre, në bazë të të cilave, mund të bëhet letësisht verifikimi nëse, plotësojnë apo përmbajnë kategoritë e punimeve të kërkuara nga autoriteti kontraktues. Licenca profesionale e operatorit të huaj është një dokument, i cili, me

përshkrimet që ka, nuk mund të shkaktojë konfuzion, ndaj njehsimi i saj pranë MPPTT nuk do të ishte i nevojshëm. Për autoritetin kontraktues e rëndësishme është që operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e koncensionit/ppp, pavarësisht se kategoria e kërkuar si p.sh. NP 1 apo NS 1 etj. nuk koresponduan si emërtim me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj, por në brendësi përshkrimi ka të bëjë me atë të kërkuar nga autoriteti kontraktues në dokumentat e koncensionit/ppp, pra nëse është kërkuar NP 1 - Punime gërmimi në tokë, rëndësi ka që një operator ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij, punime gërmimi në tokë pavarësisht se nuk është me kategorinë NP 1 si emërtim.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se *Në pikën 3.2.2. nuk është sqaruar se për sa kohë (pra sa ditë) duhet të jetë i vlefshëm sigurimi i ofertës mbas përfundimit të mbarimit të vlefshmërisë së ofertave, çka rezulton të jetë lënë bosh, i paplotësuar.[...] Në dokumentat e koncensionit/ppp duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.*

Sa më sipër AK duhet të përcaktojë periudhën e vlefshmërisë së ofertës bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës.

E njëjta problematikë vërehet dhe tek pika 3.4. ku sërish kohëzgjatja e vlefshmërisë së ofertave rezulton pa afat (e paplotësuar) pasi në kuptim të bazës ligjore të sipërcituar është e paqartë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e koncensionit/ppp, Njoftimi i Kontratës, Seksioni 4, pika 4.5 është përcaktuar: *“Periudha e vlefshmërisë së ofertave: 300 (treqind) ditë”.*

Në dokumentat e koncensionit/ppp, Udhëzime për ofertuesit, pika 3.2.2. është përcaktuar: *“Sigurimi i Ofertës, kur kërkohet, është i detyrueshëm të paraqitet në formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë aktivitet. Ofertuesi duhet të garantojë, që Sigurimi i Ofertës të jetë i vlefshëm për një periudhë _____ ditore pas përfundimit të vlefshmërisë së ofertës, e cila është _____. Pra oferta duhet të sigurohet për _____ nga data e përfundimit të afatit të dorëzimit të saj. Për arsye të motivuara Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë nga Ofertuesi zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së Sigurimit të Ofertës, nëse ka patur një të tillë, në rast se rrethana të caktuara ndikojnë në shtyrjen e afatit të vlerësimit të ofertës përkatëse ose në dorëzimin e Sigurimit të Kontratës ose në çdo rast tjetër që ndikon në shtyrjen e ndonjë afati të detyrueshëm. Mos shtyrja e periudhës së vlefshmërisë së Sigurimit të Ofertës, kur kërkohet përbën shkak për skualifikimin e Ofertuesit”.*

Ndërsa në pikën 3.4. po këtu është përcaktuar: *“Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës: “Ofertat duhet të jenë të vlefshme për _____ duke filluar nga momenti i përfundimit të “afatit kohor për dorëzimin e ofertave”. Një ofertë me një vlefshmëri më të shkurtër se afati i përcaktuar do të refuzohet nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si e papranueshme.*

Në mënyrë përjashtimore, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë nga Ofertuesi zgjatjen e Periudhës së Vlefshmërisë së Ofertës. Kërkesa e Autoritetit Kontraktues dhe përgjigja e Ofertuesit duhet të jenë në formë të shkruar. Në rast të zgjatjes së Afatit të Vlefshmërisë së Ofertës, edhe afati i Sigurimit të ofertës, nëse është kërkuar, do të zgjatet në përputhje me pikën 3.2.2.”

III.2.2. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, autoriteti kontraktues ka përcaktuar një afat vlefshmërie prej 300 ditësh, ashtu siç konstatohet në pikën 4.5. të dokumentave të koncensionit/ppp, ndërkohë që vërehet se vendet e tjera të dokumentave ku përcaktohet vlefshmëria e ofertave, dhe konkretisht në pikat 3.2.2. dhe 3.4., nuk janë plotësuar me të gjitha të dhënat që kërkohen në vendet bosh, për t’u plotësuar nga autoriteti kontraktues.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit dhe kriteret për kualifikim duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike dhe të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se autoriteti kontraktues në hartimin e dokumentave të koncensionit/ppp, duhet të jetë i saktë e i qartë, duke plotësuar dhe duke vendosur në dokumentat e koncensionit/ppp, në të gjitha seksionet e tyre, çdo të dhënë apo element të domosdoshëm për operatorët ekonomikë gjatë hartimit dhe përgatitjes së ofertave të tyre. KPP gjykon se, pavarësisht se autoriteti kontraktues, ka përcaktuar një afat në lidhje me vlefshmërinë e ofertave në këto dokumenta, e ka plotësuar atë vetëm në një seksion të tyre, ndërkohë që, dokumentat e koncensionit/ppp duhet të hartohen dhe të plotësohen nga autoriteti kontraktues në të gjitha pjesët dhe seksionet e tyre, duke iu dhënë të gjithë informacionin e saktë e të duhur operatorëve ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në një procedurë konkurruese. Sa më sipër, autoriteti kontraktues duhet të plotësojë dhe unifikojë në të gjitha vendet përkatëse të dokumentave të koncensionit/ppp afatin e vlefshmërisë së ofertave.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se [...] pika 4.2.1. është lënë e paplotësuar data e përfundimit të afatit për dorëzimin e ofertave dhe ora e saj. Është detyrim i AK të saktësojë datën e përfundimit të afatit të dorëzimit të ofertave në çdo kapitull/nen/dispozitë të parashikuar në DK/PPP për të mos krijuar qartësi dhe konfuzion tek ofertuesit, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.3.1. Në dokumentat e koncensionit/ppp, Njoftimi i Kontratës, Seksioni 4, pika 4.3 është përcaktuar: “Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Data: 27/02/2014 Ora 11:00”.

Në dokumentat e koncensionit/ppp, Udhëzime për ofertuesit, pika 4.2. është përcaktuar: “Afati për dorëzimin e Ofertave”

Ofertat duhet të dorëzohen në faqen e internetit të APP brenda datës _____, ora _____. Ofertuesi i shpallur fitues do të njoftohet me shkrim nga Autoriteti Kontraktues për afatin e dorëzimit të ofertës origjinale”.

III.3.2. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, autoriteti kontraktues ka përcaktuar në një seksion të dokumentave të koncensionit/ppp datën dhe orën e dorëzimit të ofertave, ashtu siç konstatohet në pikën 4.3. të dokumentave të koncensionit/ppp, ndërkohë që vërehet se vendet e tjera të dokumentave ku përcaktohet për afatin e dorëzimit të ofertave, dhe konkretisht në pikën 4.2, nuk janë plotësuar me të gjitha të dhënat që kërkohen në vendet bosh, për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktues.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit dhe kriteret për kualifikim duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike dhe të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se autoriteti kontraktues në hartimin e dokumentave të koncensionit/ppp, duhet të jetë i saktë e i qartë, duke plotësuar dhe duke vendosur në dokumentat e koncensionit/ppp, në të gjitha seksionet e tyre, çdo të dhënë apo element të domosdoshëm për operatorët ekonomikë gjatë hartimit dhe përgatitjes së ofertave të tyre. KPP gjykon se, pavarësisht se autoriteti kontraktues, ka përcaktuar një afat në lidhje me vlefshmërinë e ofertave në këto dokumenta, e ka plotësuar atë vetëm në një seksion të tyre, ndërkohë që, dokumentat e koncensionit/ppp duhet të hartohen dhe të plotësohen nga autoriteti kontraktues në të gjitha pjesët dhe seksionet e tyre, duke iu dhënë të gjithë informacionin e saktë e të duhur operatorëve ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në një procedurë konkurruese. Sa më sipër, autoriteti kontraktues duhet të plotësojë dhe unifikojë në të gjitha vendet përkatëse të dokumentave të koncensionit/ppp datën dhe orën e dorëzimit të ofertave.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se [...] *kriteri Eksperiencë operacionale dhe mirëmbajtjeje*

Ofertuesi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme minimale:

(a) *Operimin e një stacioni të transportit publik të një lloji dhe kompleksiteti të krahasueshëm me projektin e propozuar, të një lloji dhe kompleksiteti të krahasueshëm me shërbimet e propozuara, me rezultate të kënaqshme dhe të përfunduara prej tij si kontraktues kryesor, anëtar i një sipërmarrjeje të përbashkët, kontraktues menaxhues ose nënkontraktues, brenda pesë viteve të fundit.*

2. *Shërbime të ngjashme me objektin e Koncesionit/Partneritetit Publik Privat me vlerë 40% e vlerës sëpërlllogaritur të shërbimeve të parashikuara në project dhe konkretisht: 300.000 (treqind mijë) Euro pa TVSH, të realizuara gjatë pesë viteve të fundit.*

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- c) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me situacionet për shërbimet e kryera dhe vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plote dhe të suksesshëm të kësaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar.
- d) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatëse të shitjes (ku të shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara). me situacionet për shërbimet e kryera.

[...] të ndryshojë si më poshtë:

”Operimin e një stacioni të transportit publik të një lloji dhe kompleksiteti të krahasueshëm me projektin e propozuar, të një lloji dhe kompleksiteti të krahasueshëm me shërbimet e propozuara, me rezultate të kënaqshme dhe të përfunduara prej tij si kontraktues kryesor, anëtar i një sipërmarrjeje të përbashkët, kontraktues menaxhues ose nënkontraktues, brenda pesë viteve të fundit.

Shërbime të ngjashme me objektin e koncesionit/partneritetit publik privat me vlerë 40% e vlerës së përllogaritur të shërbimeve të parashikuara në projekt dhe konkretisht: 3000 (treqind mijë) euro pa TVSH, të realizuara gjatë pesë viteve të fundit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në dokumentat e koncesionit/ppp, Shtojca 9 Formular për vërtetimin e kualifikimit/pjesëmarrjes, pika 2.3. Kapaciteti teknik, gërma “c”, është përcaktuar kriteri:

a. Eksperiencë operationale dhe mirëmbajtjeje

Ofertuesi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme minimale:

(a) Operimin e një stacioni të transportit publik të një lloji dhe kompleksiteti të krahasueshëm me projektin e propozuar, të një lloji dhe kompleksiteti të krahasueshëm me shërbimet e propozuara, me rezultate të kënaqshme dhe të përfunduara prej tij si kontraktues kryesor, anëtar i një sipërmarrjeje të përbashkët, kontraktues menaxhues ose nënkontraktues, brenda pesë viteve të fundit.

3. Shërbime të ngjashme me objektin e Koncesionit/Partneritetit Publik Privat me vlerë 40% e vlerës së përllogaritur të shërbimeve të parashikuara në project dhe konkretisht: 300.000 (treqind mijë) Euro pa TVSH, të realizuara gjatë pesë viteve të fundit.

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- e) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me situacionet për shërbimet e kryera dhe vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plote dhe të suksesshëm të kësaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar.
- f) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatëse të shitjes (ku të shprehen qartë datat, shumat dhe shërbimet e realizuara)”.

III.4.2. Në pikën 2 të nenit 22 të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, përcaktohet shprehimisht: “*Procedura për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private, me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, bëhet në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik*”.

Në pikën 5, neni 23 po këtu, përcaktohet se: “*Kriteret për dhënien e kontratës nuk duhet të jenë diskriminuese dhe duhet të jenë në përpjesëtim me objektin e koncesionit*”.

III.4.3. Në pikën 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përcaktuar: “*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve*”.

Në pikën 6 po këtu është përcaktuar: “[...] *Autoriteti kontraktues, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve*”.

Gjithashtu, në dokumentat standarte të koncesionit/ppp, të hartuara dhe miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik e të publikuara në faqen zyrtare të saj, në shtojcën 9, tek seksioni Kriteret e veçanta të kualifikimit është përcaktuar që autoriteti kontraktues duhet të plotësojë kapacitetin ligjor të operatorëve ekonomikë, kapacitetin ekonomik dhe financiar si edhe atë teknik.

III.4.4. Sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi. Referuar legjislacionit në fuqi, është përcaktuar se autoriteti kontraktues kërkon dëshmi për përvojën e mëparshme dhe në këtë kuadër, kontrata është një dokument që dëshmon më së miri përvojën e mëparshme të realizuar nga një operator ekonomik, pasi është një dokument që sigurohet nga të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar dhe që përmban të gjitha të dhënat e nevojshme për të vërtetuar punët e mëparshme të realizuara si data e lidhjes së kontratës, vlera e realizuar, objekti i kryer, palët kontraktuese etj. Autoriteti kontraktues sqaron se e ka vendosur kriterin për kontratën në kuadrin e vërtetimeve që përcakton ligji si dëshmi për përvojën e mëparshme.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kontrata është një dëshmi që provon më së miri eksperiencat e mëparshme të realizuara nga operatori ekonomik, e si rrjedhim pretendimi i operatorit ekonomik nuk qëndron.

III.5. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se kriteri “*Në DK/PPP është parashikuar:*

Eksperiencë në Projektim

Ofertuesi ose një nënkontraktues i specializuar duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme minimale:

(a) *Xhiron mesatare vjetore si kontraktuesi kryesor, anëtar i një sipër-marrjeje të përbashkët, kontraktues menaxhues ose nënkontraktues (përkufi-zuar si faturim për punët rrugore në progres dhe të përfunduara) gjatë 5 (pesë) viteve të fundit prej 500.000(pesëqind mijë) Euro*

(b) *përvojë të suksesshme si Kontraktues kryesor, anëtar sipër-marrjeje të përbashkët, kontraktues menaxhues ose nënkontraktues në projektimin e*

- të paktën një projekt dizanji me një vlerë 300.000 (treqind mijë) Euro pa TVSH; e realizuar pesë vitet e fundit ose

- projekte të shumta dizanji (prjektimi) me një vlerë 600,000 (gjashtëqind mijë) Euro pa TVSH , të realizuara pesë vitet e fundit

të një lloji dhe kompleksiteti të krahasueshëm me shërbimet e propozuara, me rezultate të kënaqshme dhe të përfunduara prej tij si kontraktues kryesor, anëtar i një sipër-marrjeje të përbashkët, kontraktues menaxhues ose nënkon-traktor, brenda pesë viteve të fundit.

Të ndryshojë si më poshtë:

“Ofertuesi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme minimale: [...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në dokumentat e koncensionit/ppp, Shtojca 9, pika 2.3. Kapaciteti teknik, gërma “d”, është përcaktuar kriteri:

“Eksperiencë në Projektim

Ofertuesi ose një nënkontraktues i specializuar duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme minimale:

(a) *Xhiron mesatare vjetore si kontraktuesi kryesor, anëtar i një sipër-marrjeje të përbashkët, kontraktues menaxhues ose nënkontraktues (përkufi-zuar si faturim për punët rrugore në progres dhe të përfunduara) gjatë 5 (pesë) viteve të fundit prej 500.000(pesëqind mijë) Euro*

(b) *përvojë të suksesshme si Kontraktues kryesor, anëtar sipër-marrjeje të përbashkët, kontraktues menaxhues ose nënkontraktues në projektimin e*

- të paktën një projekt dizanji me një vlerë 300.000 (treqind mijë) Euro pa TVSH; e realizuar pesë vitet e fundit ose

- projekte të shumta dizanji (prjektimi) me një vlerë 600,000 (gjashtëqind mijë) Euro pa TVSH , të realizuara pesë vitet e fundit

të një lloji dhe kompleksiteti të krahasueshëm me shërbimet e propozuara, me rezultate të kënaqshme dhe të përfunduara prej tij si kontraktues kryesor, anëtar i një sipër-marrjeje të përbashkët, kontraktues menaxhues ose nënkon-traktor, brenda pesë viteve të fundit.

III.5.2. Në pikën 2 të nenit 22 të ligjit nr. 125/2013 “Për koncensionet dhe partneritetin publik privat”, përcaktohet shprehimisht: “Procedura për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private, me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, bëhet në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik”.

Në nenin 34 po këtu përcaktohet shprehimisht: “1. Autoriteti kontraktues mund:

a) t'i kërkojë koncesionarit që të japë kontrata që janë minimalisht 30 për qind e vlerës totale të kontratës së koncesionit te palët e treta, duke siguruar në të njëjtën kohë, një mundësi për tenderuesit që ta rrisin këtë përqindje, ndërkohë që kjo përqindje minimale specifikohet në kontratën e koncesionit;

b) të kërkojë nga tenderuesit që të tregojnë në ofertat e tyre përqindjen e vlerës totale të kontratës që ata planifikojnë t'u caktojnë palëve të treta.

2. Për nënkontraktimin e partneriteteve publike private, që realizohen si kontrata të punëve publike ose të shërbimit publik, zbatohen dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik, në përputhje me rrethanat”.

III.5.3. Në dokumentat e koncensionit/ppp, Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, neni 21 Nënkontraktimi, përcaktohet:

21.1 Autoriteti kontraktues mund:

a) t'i kërkojë koncesionarit që të japë kontrata që janë minimalisht 30% e vlerës totale të kontratës së koncesionit te palët e treta, duke siguruar në të njëjtën kohë një mundësi për tenderuesit që ta rritin këtë përqindje, ndërkohë që kjo përqindje minimale specifikohet në kontratën e koncesionit;

b) të kërkojë nga tenderuesit që të tregojnë në ofertat e tyre përqindjen e vlerës totale të kontratës që ata planifikojnë t'u caktojnë palëve të treta.

21.2 Për nënkontraktimin e partneriteteve publike private, që realizohen si kontrata të punëve publike ose të shërbimit publik, zbatohen dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik në përputhje me rrethanat.

III.5.4. Në nenin 23 të ligjit nr. 125/2013, përcaktohet se “Kriteret për dhënien e kontratës nuk duhet të jenë diskriminuese dhe duhet të jenë në përpjesëtim me objektin e koncesionit”.

Sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktues, që nënkontraktuesi duhet të paraqesë dokumentacion për të provuar përmbushjen e kapaciteteve teknike që në fazën e parë të kualifikimit, nuk është në përputhje me përcaktimet e mësipërm ligjore. Referuar sa më sipër cituar, kriteret e veçanta të kualifikimit janë të detyrueshme për t'u plotësuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën konkurruese dhe në asnjë rast nga nënkontraktuesët/furnitorët e tyre. Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron dhe autoriteti kontraktues duhet të bëjë modifikimin përkatës duke përcaktuar që kriteret do të plotësohen nga operatori ekonomik i interesuar dhe jo nga nënkontraktuesi duke hequr togfjalëshin “ose një nënkontraktues”.

III.6. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se kriteri “Eksperiencë në Punime në infrastrukturë rrugore ose infrastrukturë Civile [...] të ndryshojë si më poshtë:

“Eksperiencë në Punime infrastrukturë Civile [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në dokumentat e koncensionit/ppp, Shtojca 9, pika 2.3. Kapaciteti teknik, janë përcaktuar kriteret: “Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktues si më poshtë:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a. *Eksperiencë në Ndërtim*

Përvojë të suksesshme në ekzekutimin e

- 1. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 40% e vlerës së përlllogaritur të projektit lidhur me ndërtimin e godinës përkatësisht në vlerën 2.600.000 (dy million e gjashtëqind mijë) Euro pa TVSH, e realizuar pesë vitet e fundit ose*
- 2. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlere monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku është në një vlerë sa dyfishi i vlerës së përlllogaritur të projektit lidhur me ndërtimin e godinës përkatësisht 12.000.000 (dymbëdhjetë milion) Euro pa TVSH, të realizuara pesë vitet e fundit*

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

a) *Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*

- 1. Deklaratën sipas shtojcës Nr.7, shoqëruar me:*
- 2. Kontratë*
- 3. Situacionin përfundimtar;*
- 4. Aktin e kolaudimit;*
- 5. Certifikaten e marrjes ne dorezim.*

b) *Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*

- 1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 7, shoqëruar me:*
- 2. Kontrate;*
- 3. Situacionin përfundimtar;*
- 4. Akt kolaudimi objekti;*
- 5. Certifikaten e marrjes ne dorezim te objektit;*
- 6. Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.*

Pika 1 plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2 duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

b. *Eksperiencë në Punime Rrugore*

Përvojë të suksesshme në ekzekutimin e

- 3. Punë të ngjashme për një kontratë në infrastrukturën rrugore të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përlllogaritur të projektit lidhur me infrastrukturën rrugore përkatësisht në vlerën 4.500.000 (katër million e pesëqind mijë) Euro pa TVSH, e realizuar pesë vitet e fundit ose*
- 4. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlere monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku është në një vlerë sa dyfishi i vlerës së përlllogaritur të projektit lidhur me ndërtimin në infrastrukturën rrugore 18.000.000 (tetëmbëdhjetë milion) Euro pa TVSH, të realizuara pesë vitet e fundit*

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

c) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

6. Deklaratën sipas shtojcës Nr.7, shoqëruar me:
7. Kontratë
8. Situacionin përfundimtar;
9. Aktin e kolaudimit;
10. Certifikaten e marrjes ne dorezim.

d) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

7. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 7, shoqëruar me:
8. Kontrate;
9. Situacionin përfundimtar;
10. Akt kolaudimi objekti;
11. Certifikaten e marrjes ne dorezim te objektit;
12. Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.

Pika 3 plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 4 duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

c) Eksperiencë operationale dhe mirëmbajtjeje

Ofertuesi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme minimale:

- (a) Operimin e një stacioni të transportit publik të një lloji dhe kompleksiteti të krahasueshëm me projektin e propozuar, të një lloji dhe kompleksiteti të krahasueshëm me shërbimet e propozuara, me rezultate të kënaqshme dhe të përfunduara prej tij si kontraktues kryesor, anëtar i një sipërmarrjeje të përbashkët, kontraktues menaxhues ose nënkontraktues, brenda pesë viteve të fundit.
- Shërbime të ngjashme me objektin e Koncesionit/Partneritetit Publik Privat me vlerë 40% e vlerës së përllogaritur të shërbimeve të parashikuara në project dhe konkretisht: 300.000 (treqind mijë) Euro pa TVSH, të realizuara gjatë pesë viteve të fundit.
Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:
 - Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me situacionet për shërbimet e kryera dhe vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plote dhe te suksesshëm të kesaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar.

- Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatase të shitjes (ku të shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara).

d. Eksperiencë në Projektim

Ofertuesi ose një nënkontraktues i specializuar duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme minimale:

(a) Xhiron mesatare vjetore si kontraktuesi kryesor, anëtar i një sipër-marrjeje të përbashkët, kontraktues menaxhues ose nënkontraktues (përkufizuar si faturim për punët rrugore në progres dhe të përfunduara) gjatë 5 (pesë) viteve të fundit prej 500.000 (pesëqind mijë) Euro

(b) përvojë të suksesshme si Kontraktues kryesor, anëtar sipër-marrjeje të përbashkët, kontraktues menaxhues ose nënkontraktues në projektimin e

- të paktën një projekti dizanji me një vlerë 300.000 (treqind mijë) Euro pa TVSH; e realizuar pesë vitet e fundit ose

- projekte të shumta dizanji (prjektimi) me një vlerë 600,000 (gjashtëqind mijë) Euro pa TVSH , të realizuara pesë vitet e fundit

të një lloji dhe kompleksiteti të krahasueshëm me shërbimet e propozuara, me rezultate të kënaqshme dhe të përfunduara prej tij si kontraktues kryesor, anëtar i një sipër-marrjeje të përbashkët, kontraktues menaxhues ose nënkon-traktor, brenda pesë viteve të fundit.

e. Eksperiencë në Punime në infrastrukturë rrugore ose infrastrukturë Civile Përvojë të suksesshme në ekzekutimin e

5. Punë të ngjashme për një kontratë të vetme në infrastrukturën rrugore ose infrastrukturë civile me një vlerë jo më të vogël se 12.000.000 (dymbëdhjetë milion) Euro pa TVSH, e realizuar gjatë pesë vitet të fundit ose punë në vazhdimësi

6. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku është në një vlerë prej 24.000.000 (njëzetë e katër milion) Euro pa TVSH, të realizuara pesë vitet e fundit ose punë në vazhdimësi

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme për punët e përfunduara

e) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

11. Deklaratën sipas shtojcës Nr.7, shoqëruar me:

12. Kontratë

13. Situacionin përfundimtar;

14. Aktin e kolaudimit;

15. Certifikaten e marrjes ne dorezim.

f) *Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*

13. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 7, shoqëruar me:

14. Kontrate;

15. Situacionin përfundimtar;

16. Akt kolaudimi objekti;

17. Certifikaten e marrjes ne dorezim te objektit;

18. Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme për punët në vazhdimësi:

- *Kontratë*
- *Fatura Tatimore deri në 30 ditë para datës së zhvillimit të procedurës*
- *Situacionet deri në 30 ditë para datës së zhvillimit të procedurës*
- *Vertetim nga investitori per vleren e realizuar deri ne 30 dite para dates se zhvillimit te procedures*

III.6.2. Referuar sa më sipër, duke e parë në këndvështrim të përgjithshëm përcaktimin e kriterit në lidhje me eksperiencat e mëparshme të ngjashme, si edhe nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimes, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktues në varësi të kontratës, volumeve të punës, studimit të fizibilitetit, specifikimeve teknike, në kushtet kur kemi të bëjmë me një kontratë shumëvjeçare dhe komplekse, në të cilën përfshihen disa lloj punimesh, ka përcaktuar që operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka kryer eksperiencat të mëparshme të ngjashme në disa fusha si ndërtime civile, rrugore etj. Autoriteti kontraktues në dokumentacionin e paraqitur argumenton se referuar zërave të përcaktuar në tabelën “Kostot e investimit”, në të cilën qartësisht është përcaktuar se janë të përfshira punime të infrastrukturës rrugore si dhe punime të infrastrukturës civile, është përcaktuar në dokumentat e koncensionit që të kërkohen punë të ngjashme që i përkasin fushës së infrastrukturës rrugore apo asaj civile. Në këtë kontekst, nga shqyrtimi i kriterëve në lidhje me eksperiencat e ngjashme të mëparshme, konstatohet se, janë përcaktuar kriteret për kontratat që janë përfunduar si edhe për kontratat që janë në proces apo vazhdimësi. Autoriteti kontraktues ka përcaktuar kriterin në varësi të volumit të punëve për kontrata të ngjashme në punime rrugore – kontrata të përfunduara dhe të realizuara, kontrata të ngjashme në ndërtim – të përfunduara dhe të realizuara, eksperiencë operationale dhe mirëmbajtje për kontrata të përfunduara, eksperiencë në projektim për kontrata të përfunduara, eksperiencë në punime në infrastrukturë rrugore ose infrastrukturë civile për kontrata të përfunduara ose punë në vazhdimësi. Në kushtet kur në volumet e punës së kësaj kontrate komplekse konstatohet se ka zëra për infrastrukturë rrugore dhe civile, autoriteti kontraktues argumenton se nuk do të ishte e rregullt të kërkoheshin kontrata specifikuishet vetëm për një lloj strukture pasi nuk do të quheshin punime të ngjashme. Në këtë kontekst, autoriteti kontraktues në kriterin për eksperiencat e ngjashme për infrastrukturë rrugore ose civile ku ka përcaktuar kontrata për punët e përfunduara ose në vazhdim ka lënë një diapazon më të gjerë duke mos krijuar pengesa dhe kufizim të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, por duke lejuar një pjesëmarrje më të gjerë dhe duke përfshirë të kombinuar eksperiencat në infrastrukturën rrugore ose civile.

Sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.7. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se *kriteri “Vlerësimi i përvojës së suksesshme të operatorit ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme për punët në vazhdimësi:*

- *“Fatura tatimore derinë 30 ditë para datës së zhvillimit të procedurës*
- *Situacionet deri në 30 ditë para datës së zhvillimit të procedurës*
- *Vërtetim nga investitori për vlerën e realizuar deri në 30 ditë para datës së zhvillimit të procedurës, duhet hequr, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se:*

III.7.1. Në dokumentat e koncensionit/ppp, Shtojca 9, pika 2.3. Kapaciteti teknik është përcaktuar kriteri: *“Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme për punët në vazhdimësi:*

- *Kontratë*
- *Fatura Tatimore deri në 30 ditë para datës së zhvillimit të procedurës*
- *Situacionet deri në 30 ditë para datës së zhvillimit të procedurës*
- *Vertetim nga investitori per vleren e realizuar deri ne 30 dite para dates se zhvillimit te procedures*

III.7.2. Në pikën 2 të nenit 22 të ligjit nr. 125/2013 *“Për koncensionet dhe partneritetin publik privat”*, përcaktohet shprehimisht: *“Procedura për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private, me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, bëhet në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik”.*

Në pikën 5, neni 23 po këtu, përcaktohet se: *“Kriteret për dhënien e kontratës nuk duhet të jenë diskriminuese dhe duhet të jenë në përpjesëtim me objektin e koncesionit”.*

III.7.3. Në pikën 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, është përcaktuar: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

Gjithashtu, në dokumentat standarte të koncensionit/ppp, të hartuara dhe miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik e të publikuara në faqen zyrtare të saj, në shtojcën 9, tek seksioni Kriteret e veçanta të kualifikimit është përcaktuar që autoriteti kontraktues duhet të plotësojë kapacitetin ligjor të operatorëve ekonomikë, kapacitetin ekonomik dhe financiar si edhe atë teknik.

III.7.4. Sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën

përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi. Në rastin konkret, kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktues ka të bëjë me punët në vazhdimësi dhe si e tillë është e domosdoshme që ky i fundit për këto punë të përcaktojë një afat për paraqitjen e dokumentacionit që vërteton realizimin e punëve të kryera pjesore. Pra, autoriteti kontraktues në këtë rast, ka favorizuar operatorët ekonomikë duke i lënë mundësinë e paraqitjes së eksperiencave të mëparshme të cilat nuk janë përfunduar por janë në vazhdimësi, të cilët rrjedhimisht duhet të paraqesin dokumentacionin për vërtetimin e kryerjes së këtyre eksperiencave brenda një afati 30 ditor nga data e zhvillimit të procedurës. Sqarojmë këtu se, nuk jemi në rastin e eksperiencave të përfunduara, për të cilat nuk ka rëndësi data e marrjes së vërtetimit të realizimit, fatura apo situacioni, pasi kjo punë është kryer dhe është përfunduar, por në këtë rast, është e domosdoshme që autoriteti kontraktues të njihet me dokumentacion sa më të afërt me datën e hapjes së procedurës për realizimin me sukses të kontratave në vazhdimësi.

Autoriteti kontraktor ka argumentuar se *vlera e kontratës do të rezultojë nga kontrata e ngjashme e paraqitur nga operatori ekonomik dhe faturat e paraqitura deri në 30 ditë para datës së hapjes së procedurës i krijojnë mundësi autoritetit kontraktor që të vërtetojë se kontrata është duke u realizuar por si kontratë në vazhdimësi me faturat e paraqitura nuk do të plotësohet vlera e plotë e kontratës por vlera e realizuar deri në momentin e hapjes së procedurës.*

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, në kushtet kur kërkohet dokumentacion për punët e papërfunduara, pra ato në vazhdimësi, kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktues, për paraqitjen e dokumentacionit provues të eksperiencës së mëparshme brenda 30 ditëve para datës së zhvillimit të procedurës nuk është pengues dhe nuk përjashton operatorët ekonomikë nga pjesëmarrja në procedurën konkurruese.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.8. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se kriteri 2.2. *Kapaciteti financiar* “Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 5 (pesë) viteve të fundit ushtrimore (2011, 2012, 2013, 2014, 2015), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me AK Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të ndryshohet si më poshtë:

“Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 5 (pesë) viteve të fundit ushtrimore (2011, 2012, 2013, 2014, 2015), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të shoqëruara me auditimin ligjor në përputhje me ligjin 10 091 dt. 05.03.2009”.

Ose

“Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 5 (pesë) viteve të fundit ushtrimore (2011, 2012, 2013, 2014, 2015), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të shoqëruara me auditimin ligjor nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese”.

[...]

Sa më sipër, kërkohet gjithashtu që të shtohet një paragraf ku të sqarohet se:

“Për ofertuesit e huaj të paraqiten dokumentat e mësipërme në përputhje me legjislacionin në vendin e origjinës”.

III.8.1. Në dokumentat e koncensionit/ppp, Shtojca 9, pika 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar, gërma “a”, është përcaktuar kriteri: *“Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 5 (pesë) viteve të fundit ushtrimore (2011,2012,2013,2014,2015), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar.*

III.8.2. Në ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 *“Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”*, i ndryshuar, është përcaktuar shprehimisht:

Neni 2:

"1."Auditim ligjor" është një auditim i pavarur i pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe/ose të konsoliduara, nëse:

a) kërkohet nga ky ligj;

b) kërkohet nga ligje të tjera;

c) kryhet në mënyrë vullnetare, me kërkesë të ortakëve/aksionarëve të njësive ekonomike të biznesit ose nga palë të tjera të interesuara, kur për auditimin ligjor zbatohen standarde dhe kërkesa të legjislacionit, të barasvlershme me ato që kërkohen për një auditim ligjor, sipas shkronjës "a" të kësaj pike."

"7. "Auditues ligjor" është individ i miratuar nga autoritetet kompetente për të kryer auditime ligjore, si dhe i regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji."

Në nenin 32, po këtu përcaktohet: *“Sa herë që në ligjet e posaçme referohet në termat "ekspert kontabël i autorizuar", "ekspert kontabël i regjistruar", "ekspert kontabël" ose "auditues i jashtëm", referenca vlerësohet si e bërë në termin "auditues ligjor".*

III.8.3. Në pikën 2 të nenit 22 të ligjit nr. 125/2013 *“Për koncensionet dhe partneritetin publik privat”*, përcaktohet shprehimisht: *“Procedura për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private, me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, bëhet në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik”.*

Në pikën 5, neni 23 po këtu, përcaktohet se: *“Kriteret për dhënien e kontratës nuk duhet të jenë diskriminuese dhe duhet të jenë në përpjesëtim me objektin e koncesionit”.*

III.8.4. Në pikën 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, është përcaktuar: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

III.8.5. Në pikën 7 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht: *“Për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktues kërkon:*

a) kopje të çertifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse; dhe/ose [...]”.

III.8.6. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi.

Gjithashtu, në dokumentat standarte të koncensionit/ppp, të hartuara dhe miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik e të publikuara në faqen zyrtare të saj, në shtojcën 9, tek seksioni Kriteret e veçanta të kualifikimit është përcaktuar që autoriteti kontraktues duhet të plotësojë kapacitetin ligjor të operatorëve ekonomikë, kapacitetin ekonomik dhe financiar si edhe atë teknik.

III.8.7. Autoriteti kontraktues në informacionin dhe dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, sqaron se: *[...] Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që bilancet të jenë të konfirmuara nga administrata tatimore referuar ligjit ku citohet “kopje të çertifikuara të bilanceve”.*

Gjithashtu autoriteti kontraktues ka kërkuar që bilancet të jenë të shoqëruara me akt ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Referuar Ligjit 10091, date 05.03.2009 “Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të ekspertit kontabël dhe të kontabilistit të miratuar”, Neni 2 është qartësisht e përcaktuar se: Auditimi ligjor është: auditimi i pavarur, i detyrueshëm i pasqyrave financiare vjetore individuale dhe/ose të konsoliduara të personave juridik dhe që kryhet nga ekspertë kontabël të rregjistruar”. Pra është e pakuptueshme se ku qëndron pretendimi i ankimesit në lidhje me këtë pikë”.

III.8.8. Sa më sipër, analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se në legjislacionin në fuqi është përcaktuar qartë që autoriteti kontraktues për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të çertifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse, çka rrjedhimisht është konfirmimi i këtij dokumenti nga organi pranë të cilit paraqitet, ndaj përcaktimi i këtij kriteri nuk vjen në kundërshtim me bazën ligjore si më sipër cituar, dhe nuk krijon pengesa për operatorët ekonomikë të interesuar për këtë procedurë konkurruese.

III.8.9. Përsa i përket pretendimit të ankimesit në lidhje me ekspertin kontabël të autorizuar, KPP sqaron se ashtu edhe siç është cituar më sipër, referuar ligjit për auditim, është përcaktuar qartazi se auditimi ligjor është një auditim i pavarur i pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe/ose të konsoliduara, nëse: a) kërkohet nga ky ligj; b) kërkohet nga ligje të tjera; c) kryhet në mënyrë vullnetare, me kërkesë të ortakëve/aksionarëve të njësisve ekonomike të biznesit ose nga palë të tjera të interesuara, kur për auditimin ligjor zbatohen standarde dhe kërkesa të legjislacionit, të barasvlershme me ato që kërkohen për një auditim ligjor, sipas shkronjës "a" të kësaj pike.”.

Ndërsa audituesi ligjor është individ i miratuar nga autoritetet kompetente për të kryer auditime ligjore, si dhe i regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Nga ana tjetër po në këtë ligj është përcaktuar që në termat

"ekspert kontabël i autorizuar", "ekspert kontabël i regjistruar", "ekspert kontabël" ose "auditues i jashtëm", referenca vlerësohet si e bërë në termin "auditues ligjor".

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktues është në përputhje me objektin dhe natyrën e procedurës konkurruese, përsa kohë që nuk është përcaktuar asnjë element diskriminues dhe i paparashikuar në legjislacionin në fuqi, në kushtet kur audituesi ligjor përfshin dhe nënkupton edhe termin "ekspert kontabël i miratuar", sqaruar kjo më së mirin në ligjin nr. 10091, datë 5.3.2009, aq më tepër kur nga vetë ankimuesi pretendohet që të përcaktohet kriteri që "[...] bilancet të jenë të shoqëruara me auditim ligjor[...]".

Pra sa më sipër, vetë operatori ekonomik ankimues me pretendimin e tij, referuar analizës së mësipërme, arrin në të njëjtin përfundim dhe kriter të përcaktuar nga autoriteti kontraktues.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.8.10. Për sa i përket kriterit për bilancet e konfirmuara dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në kushtet kur kjo procedurë konkurruese është ndërkombëtare dhe është e hapur pjesëmarrja edhe e operatorëve të huaj, autoriteti kontraktues në këtë rast, për këto kërkesa duhet të përcaktojë që në rastin e moslëshimit të këtyre dokumentave në vendin e origjinës, në rastin e ofertuesve të huaj, ky kriter të rregullohet sipas legjislacionit në vendin e origjinës ose të paraqiten dokumenta ekuivalente me to ose deklaratë me shkrim.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron dhe autoriteti kontraktues duhet të bëjë modifikimin përkatës në lidhje me këtë kriter.

III.9. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se kriteri në pikën 2.3. *Kapaciteti teknik i ofertuesit, në pikën a (Eksperiencë në ndërtim), në pikën b Eksperiencë në punime rrugore në fund të tyre është sqaruar se:*

Pika 3 plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 4 duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.9.1. Në dokumentat e koncensionit/ppp, Shtojca 9, pika 2.3. Kapaciteti teknik, gërma "a" dhe "b", është përcaktuar përkatësisht:

a. Eksperiencë në Ndërtim

Përvojë të suksesshme në ekzekutimin e

- 7. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 40% e vlerës së përllogaritur të projektit lidhur me ndërtimin e godinës përkatësisht në vlerën 2.600.000 (dy milion e gjashtëqind mijë) Euro pa TVSH, e realizuar pesë vitet e fundit ose*
- 8. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku është në një vlerë sa dyfishi i vlerës së përllogaritur të projektit lidhur me ndërtimin e godinës përkatësisht 12.000.000 (dymbëdhjetë milion) Euro pa TVSH, të realizuara pesë vitet e fundit*

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

g) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- 16. Deklaratën sipas shtojcës Nr.7, shoqëruar me:*
- 17. Kontratë*
- 18. Situacionin përfundimtar;*
- 19. Aktin e kolaudimit;*
- 20. Certifikaten e marrjes në dorezim.*

h) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- 19. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 7, shoqëruar me:*
- 20. Kontrate;*
- 21. Situacionin përfundimtar;*
- 22. Akt kolaudimi objekti;*
- 23. Certifikaten e marrjes në dorezim të objektit;*
- 24. Fatura tatimore për çdo situacion punimesh.*

Pika 1 plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2 duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

b. Eksperiencë në Punime Rrugore

Përvojë të suksesshme në ekzekutimin e

9. *Punë të ngjashme për një kontratë në infrastrukturën rrugore të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përllogaritur të projektit lidhur me infrastrukturën rrugore përkatësisht në vlerën 4.500.000 (katër milion e pesëqind mijë) Euro pa TVSH, e realizuar pesë vitet e fundit ose*
10. *Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku është në një vlerë sa dyfishi i vlerës së përllogaritur të projektit lidhur me ndërtimin në infrastrukturën rrugore 18.000.000 (tetëmbëdhjetë milion) Euro pa TVSH, të realizuara pesë vitet e fundit*

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

21. *Deklaratën sipas shtojcës Nr.7, shoqëruar me:*
22. *Kontratë*
23. *Situacionin përfundimtar;*
24. *Aktin e kolaudimit;*
25. *Certifikaten e marrjes ne dorezim.*

j) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

25. *Deklaratën sipas shtojcës Nr. 7, shoqëruar me:*
26. *Kontrate;*
27. *Situacionin përfundimtar;*
28. *Akt kolaudimi objekti;*
29. *Certifikaten e marrjes ne dorezim te objektit;*
30. *Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.*

Pika 3 plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 4 duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

III.9.2. Operatori ekonomik ankimes në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik pretendon se: “[...] Së pari, sqarojmë se procedura e partneritetit publik privat është një procedurë komplekse e cila realizohet nëpërmjet burimeve të financimit të vet ofertuesit pjesëmarrës dhe realizimin e veprës po me mjetet dhe kapacitetet e tij.

Sa më sipër referuar kërkit tuaj, nëse një shoqëri bankare ose institucion financiar kërkon të angazhojë fondet e saj në bashkëpunimin me një shoqëri ndërtimi për realizimin e veprës, ky bashkim do të ishte i pamundur pasi referuar kërkit tuaj, edhe vetë institucioni financiar duhet të ketë eksperiencë në ndërtim në aq përqind sa do të marrë pjesë në bashkim. Një absurditet i cili në gjykimin tonë ka për qëllim favorizimin e një subjekti në Republikën e Shqipërisë pasi siç vërehet lehtësisht ky kriter nuk është parashikuar në pikën C. Është e paqartë se përse pikërisht ky kërkim është vetëm për pjesën e ndërtimit dhe tek pjesa e eksperiencës operacionale mungon një kërkim i tillë?!

Mëse paku ky është një standart i dyzuar prandaj kërkojmë heqjen e tij. Përse duhet të vendoset një kusht i tillë vetëm për pjesën e ndërtimit? Mbi çbazë ligjore është referuar AK në përcaktimin e këtij kriteri pasi ligji në fuqi e ka të shprehur shumë qartë dhe nuk krijon ndasi midis punëve ose shërbimit.

Arsyetimi i mësipërm i referohet nenit 26 të VKM 914, datë 29.12.2014.... Nuk jemi në rastet e procedurave të koncensionit/ppp, por koncension/ppp ku konsorciumi ofertues përbëhet nga shoqëri projektuese, IT, shoqëri që kanë eksperiencë në mirëmbajtje operacionale (terminalesh) dhe shoqëri ndërtimi. Si mund të plotësojë shoqëria e IT (e nevojshme për zgjidhjen e IT apo e projektimit kushtin e mësipërm për eksperiencë në ndërtim rrugësh apo ndërtime civile?

Kjo bie në kundërshtim me nenin 25 të VKM 575 e cila përcakton se Çdo operator ekonomik duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në legjislacionin në fuqi dhe ato të përcaktuara në dokumentat e koncensionit/ppp “Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë grupi, i marrë së bashku në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë/shërbim të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.9.3. Në nenin pikën 2 të nenit 22 të ligjit nr. 125/2013 “Për koncensionet dhe partneritetin publik privat”, përcaktohet shprehimisht: “Procedura për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private, me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, bëhet në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik”.

Në pikën 5, neni 23 po këtu, përcaktohet se: “Kriteret për dhënien e kontratës nuk duhet të jenë diskriminuese dhe duhet të jenë në përpjesëtim me objektin e koncesionit”.

Në pikën 7 të nenit 24 të ligjit 125/2013 përcaktohet: “Për të gjitha çështjet e njoftimit të kontratës, që nuk rregullohen nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, zbatohet ligji për prokurimin publik, në përputhje me rrethanat”.

III.9.4. Në nenin 25 të VKM nr. 575, datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncension/partneritet publik privat”, është përcaktuar: “Bashkimi i operatorëve ekonomikë

- 1. Operatorët ekonomikë mund të ofertojnë të vetëm ose të krijojnë grupe operatorësh ekonomikë dhe të ofertojnë si një kandidat i vetëm. Në rast të bashkimit të grupeve të operatorëve ekonomikë, autoriteti kontraktues duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të*

dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

- 2. Oferta mund të paraqitet nga një grup operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit ose e punës që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi.*
- 3. Para dorëzimit të ofertës, grupi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi.*
- 4. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e grupit caktojnë, me prokurë, përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në procedurë në emër të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë.[...].*
- 5. Çdo operator ekonomik duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në legjislacionin në fuqi dhe ato të përcaktuara në dokumentet e konkensionit/ppp. “Kërkesat ekonomike,financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë grupi, i marrë së bashku, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë/shërbim të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

III.9.5. Autoriteti kontraktues në informacionin dhe dokumentacionin e paraqitur, sqaron se: “[...] Referuar ligjit për konkensionin/PPP autoriteti kontraktues në mbështetje të Nenit 22 të ligjit 125/2013 .Për konkensionet dhe partneritetin publik privat” (i ndryshuar), ku citohet se: “Procedura për dhënien e konkensioneve/PPP me vlerë mbi kufirin e ulët monetar bëhet në përputhje me dispozitat përkatëse të LPP për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj” ka vënë këtë kriter bazuar në ligjin për prokurimin publik.

Pra sa më sipër autoriteti kontraktues ka vendosur kriterin në mbështetje të VKM Nr.914, datë 29.12.2014, Kreu VII, Neni 74, pika 3”.

III.9.6. Sa më sipër cituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të referohet në legjislacionin e posaçëm dhe konkretisht në rregulloren përkatëse për vlerësimin dhe dhënien me konkension/ppp, e cila prevalon mbi VKM nr. 914, datë 29.12.2014 në të cilën është bazuar autoriteti kontraktues në argumentimin e tij, pasi në këtë rregullore eksplicite për konkensionet dhe partneritetet publike private, është përcaktuar më së qarti që në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë grupi, i marrë së bashku, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë/shërbim të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.9.7. Sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën

përgjegjësini e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi.

Në rastin konkret, kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktues në lidhje me eksperiencat e mëparshme të ngjashme, përsa i përket rastit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, vjen në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për koncensionet/ppp duke krijuar pengesë dhe kufizim në pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të interesuar për këtë procedurë konkurruese.

Rrjedhimisht, sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktues duhet të bëjë modifikimin përkatës të kriterit të mësipërm në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi në rastin e procedurave konkurrues të koncensionit/partneritetit publik privat.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.10. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se kriteri “*Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt (drejtuesi teknik duhet të ketë mbi 20 (njëzet) vjet eksperiencë pune e pasqyruar kjo në librezën e punës). Gjykojmë se ky kriter i AK është i ekzagjeruar pasi eksperiencia e kërkuar është e tepërt dhe ska asnjë bazë ligjore*”, duhet të modifikohet si më poshtë:

“Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin teknik të punimeve në objekt (drejtuesi teknik duhet të ketë mbi 5 (pesë) vjet eksperiencë pune e pasqyruar kjo në librezën e punës ose me dokumentat ekuivalent)”.

III.10.1. Në dokumentat e koncensionit/ppp, Shtojca 9, pika 2.4. Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, pika 3, është përcaktuar kriteri: “*Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt (drejtuesi teknik duhet të ketë mbi 20 (njëzetë) vjet eksperiencë pune e pasqyruar kjo në librezën e punës), të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:*

- i. *Librezë pune (përkatëse)*
- ii. *CV përkatëse*
- iii. *Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)*
- iv. *Diplomë”.*

III.10.2. Në pikën 2 të nenit 22 të ligjit nr. 125/2013 “Për koncensionet dhe partneritetin publik privat”, përcaktohet shprehimisht: “*Procedura për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private, me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, bëhet në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik*”.

Në pikën 5, neni 23 po këtu, përcaktohet se: “*Kriteret për dhënien e kontratës nuk duhet të jenë diskriminuese dhe duhet të jenë në përpjesëtim me objektin e koncesionit*”.

Në pikën 7 të nenit 24 të ligjit 125/2013 përcaktohet: “Për të gjitha çështjet e njoftimit të kontratës, që nuk rregullohen nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, zbatohet ligji për prokurimin publik, në përputhje me rrethanat”.

III.10.3. Në nenin 26, pika 8 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktues kërkon:

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose
- b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.10.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “a” e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktues i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

- b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktues në njoftimin e objektit të kontratës”.

III.10.5. Operatori ekonomik ankimes në lidhje me këtë kriter pretendon se: “[...] Gjykojmë se ky kriter i AK është i ekzagjeruar pasi eksperiencën e kërkuar është e tepërt dhe ska asnjë bazë ligjore.

Së pari, referuar neni 24 të VKM nr. 575, datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat:

Për të gjitha çështjet e njoftimit të kontratës, që nuk rregullohen nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij zbatohet ligji për prokurimin publik në përputhje me rrethanat.

VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 26, Kontrata e Punëve:

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktues kërkon:

- Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit

VKM ne. 575 datë 10.07.2013, neni 23[...]

Sa më sipër kërkimi i AK është i tepërt dhe nuk është në përpjesëtim me kërkesat e tjera të përcaktuara në DK/PPP ku referuar kërkimit për eksperiencën e ngjashme kërkohet të 5 viteve të fundit.

Si rrjedhojë kërkojmë ndryshimin e kriterit si më poshtë:

“Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin teknik të punimeve në objekt (drejtuesi teknik duhet të ketë mbi 5

(pesë) vjet eksperiencë pune e pasqyruar kjo në librezën e punës ose me dokumentat ekuivalent).

Duhet të nënvizojmë se në të gjithë vendet e bashkimit europian dhe në SHBA, librezat e punës e individit është një e dhënë tepër konfidenciale, pasi përmban të dhëna sekrete si pagesa e individëve ndër vite e atë më tepër e stafit teknik (inxhinierëve). Duke qenë të dhëna sensitive, ligjet e shteteve të origjinës e ndalojnë publikimin e saj. Shoqëria jonë kupton se qëllimi i kërkesës së autoritetit kontraktues është të provohet eksperiencia e drejtuesit teknik, por duke marrë shkas që procedura e mësipërme e koncensionit/PPP është e hapur ndërkombëtare dhe si e tillë nuk mund të diskriminohen subjektet e huaja dhe të avantazhohen ato vendase, kërkojmë që të ndryshohet kriteri i mësipërm dhe të pranohet edhe çdo dokumentacion ekuivalent i njohur nga shteti i origjinës me anë të së cilit provohet eksperiencia e drejtuesit teknik”.

III.10.6. Autoriteti kontraktues në informacionin e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumenton se: “Këto kërkesa janë vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), Neni 46, pika 1 gërma “b”, neni 44, pika 1, si dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, Kreu III, Seksioni II, Neni 26 pika 8/b.

Pra sa më sipër cituar ligji dhe aktet nënligjore në zbatim të tij e lënë në diskrecionin e autoritetit kontraktues të kërkojë kualifikime profesionale të personelit përgjegjës me qëllim zbatimin e kontratës në fjalë. Referuar kontratës e cila është shumë komplekse autoriteti ka vendosur të kërkojë experiencë 20 vjeçare për drejtuesin teknik i cili është personi përgjegjës në objekt për realizimin e kontratës”.

III.10.7. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktues për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Është në të drejtën e autoritetit kontraktues të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin në fuqi duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik dhe ligjit për koncensionet dhe partneritetin publik privat.

III.10.8. Në rastin konkret, referuar edhe argumentimeve të autoritetit kontraktues, KPP gjykon se përcaktimi i këtij kriteri është në përputhje me objektin, natyrën dhe volumin e kësaj kontrate, e cila është një kontratë komplekse dhe kërkon kualifikime profesionale të stafit përgjegjës me qëllim zbatimin e kontratës në fjalë. Sa më sipër, përcaktimi i eksperiencës së drejtuesit teknik është një kriter i domosdoshëm për ecurinë e këtij objekti shumëvjeçar dhe në përpjesëtim me natyrën e kësaj procedure, fondin limit të saj, afatin dhe specifikat e kësaj vepre.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues në lidhje me vitet e eksperiencës së drejtuesit teknik, nuk qëndron.

III.10.9. Për sa i përket kriterit për paraqitjen e librezës së punës, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa për një kriter të tillë nuk është diskriminuese dhe penguese për pjesëmarrjen në këtë procedurë konkurruese, pasi nëpërmjet këtij dokumenti autoriteti kontraktues arrin të provojë eksperiencën dhe vitet e punës së drejtuesit teknik të një shoqërie. Sqarojmë se ky kriter është i përshtatshëm dhe i nevojshëm për arritjen e synimit të kërkuar nga autoriteti kontraktues si edhe është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do prokurohet.

III.10.10. Referuar pretendimit të ankimuesit për dokumentacion ekuivalent, në kushtet kur kjo procedurë konkurruese është ndërkombëtare dhe është e hapur pjesëmarrja edhe e operatorëve të huaj, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktues në këtë rast, në kërkesën për librezën e punës e cila shërben për të vërtetuar eksperiencën e drejtuesit teknik të një shoqërie duhet të përcaktojë edhe kriterin për paraqitjen e dokumentacionit ekuivalent nga shteti i origjinës që provon këtë eksperiencë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron në lidhje me vitet e eksperiencës së drejtuesit teknik dhe qëndron në lidhje me librezën e punës që autoriteti kontraktues duhet të kërkojë dokument ekuivalent nga shtetet e origjinës në rastin e operatorëve të huaj, ndaj autoriteti kontraktues duhet ta modifikojë në lidhje me këtë kërkesë.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.11. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se kriteri *ku AK ka kërkuar një punësim mesatar prej 300 punonjësish për periudhën Janar 2014 – Dhjetor 2016; kriteri ku AK kërkon që inxhinierët e kërkuar të figurojnë prej periudhës Janar 2015 – Dhjetor 2016; si edhe kërkesa që mjeku të figurojë për periudhën Dhjetor 2014 – Dhjetor 2016, të ndryshohet duke barazuar kohën e kërimit të tyre[...]; kriteri në lidhje me dorëzimin e List Pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2014-Dhjetor 2016 shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore është një kriter diskriminues dhe paraqitja e listëpagesave për të gjithë periudhën e kërkuar kërkojmë që të hiqet; Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.11.1. Në dokumentat e koncensionit/ppp, Shtojca 9, pika 2.4. Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, pikat 4, 5 janë përcaktuar kriteret përkatësisht:

4. *Një punësim mesatar i të paktën 300 (treqind) personave, për periudhën Janar 2014 - Dhjetor 2016 të vërtetuar me;*

4.1 *Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen Janar 2014 - Dhjetor 2016*

4.2 List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Janar 2014 - Dhjetor 2016 shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.

5. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te kenë pjesë të stafit teknik të punësuar të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV dhe të figurojnë në listpagesa per periudhen Janar 2015-dhjetor 2016:

- Inxhinier Ndertimi (4)
- Inxhinier Topograf (2)
- Inxhinier Elektrik (1)
- Inxhinier Elektronik(3)
- Inxhinier Mekanik (2)
- Inxhinier Mjedisi (1)
- Inxhinier Informatik (1)
- Inxhinier Hidroteknik (1)
- 5.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1(nje) mjek ndërmarrjeje, kjo të vërtetohet me paraqitjen Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe Kontratës së Punës së mjekut me operatorin ekonomik e vlefshme për periudhën e ndërtimit dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën dy vitet e fundit, përkatësisht periudhën Dhjetor 2014- Dhjetor 2016. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, të paktën antari kryesues I bashkimit duhet të plotësojë këtë kusht të ketë 1 mjek ndërmarrjeje”.

III.11.2. Në pikën 2 të nenit 22 të ligjit nr. 125/2013 “Për koncensionet dhe partneritetin publik privat”, përcaktohet shprehimisht: “Procedura për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private, me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, bëhet në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik”.

Në pikën 5, neni 23 po këtu, përcaktohet se: “Kriteret për dhënien e kontratës nuk duhet të jenë diskriminuese dhe duhet të jenë në përpjesëtim me objektin e koncesionit”.

Në pikën 7 të nenit 24 të ligjit 125/2013 përcaktohet: “Për të gjitha çështjet e njoftimit të kontratës, që nuk rregullohen nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, zbatohet ligji për prokurimin publik, në përputhje me rrethanat”.

III.11.3. Në nenin 26, pika 8 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktues kërkon:

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose
- b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.11.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “a” e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e

mëposhtme, që autoriteti kontraktues i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

- a) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktues në njoftimin e objektit të kontratës”.

III.11.5. Operatori ekonomik ankimes në lidhje me këtë kriter pretendon se: “[...] AK ka kërkuar një punësim mesatar prej 300 punonjësish për periudhën Janar 2014 – Dhjetor 2016.

Një kërkim ky i çmuar nga AK si i nevojshëm për t’u njohur mbi kapacitetet e ofertuesit pjesëmarrës. Por ajo çka ngre dyshime është pikërisht kërkimi tjetër i AK kur kërkon që inxhinierët e kërkuar të figurojnë prej periudhës Janar 2015 – Dhjetor 2016 ????

Pra lehtësisht vërehet se kemi një mospërputhje me kërkimet e AK.

Akoma më abuzive bëhet përpjekja kur kërkohet që mjeku të figurojë për periudhën Dhjetor 2014 – Dhjetor 2016.

Sa më sipër, kërkojmë ndryshimin e kriterëve të lartpërmendura duke barazuar kohën e kërkimit të tyre.

[...]

Gjithashtu, në rastin konkret, mendojmë se parashikimi i mësipërm në lidhje me dorëzimin e List Pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2014 - Dhjetor 2016 shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore është një kriter diskriminues duke avantazhuar haptazi operatorët shqiptarë. Së pari, duhet të theksojmë se listëpagesat janë konfidenciale (i përkasin shoqërisë) dhe përmbajnë të dhëna tregtare mbi pagesat e personelit, të cilat nuk i interesojnë autoritetit kontraktues në momentin e parakualifikimit. Përse kërkohen listëpagesat e dy viteve, ku të pasqyrohen të treqind punonjësit, pagat e tyre, kur autoriteti kontraktues farë mirë mund të kërkojë vërtetime se ekspertët si (inxhinierët, specialistët e certifikuar të cilët janë kërkuar të figurojnë në listëpagesav për periudhën e kërkuar. Pra sa më sipër, duke menduar se paraqitja e listëpagesave për të gjithë periudhën e kërkuar nuk ndikon aspak në vlerësimin e kapaciteteve teknike, pasi informacioni mbi dëshminë e fuqisë punëtore merret me anë të vërtetimit, atëherë kërkojmë që ky kriter të hiqet. Madje, kërkesa për dorëzimin e formularëve të pagimit të detyrimeve shoqërore dhe shëndetësore është një kërkesë që i referohet ligjit shqiptar, pasi në vendet e huaja për kompani ndërkombëtare, një informacion i tillë nuk aplikohet por me anë të vërtetimeve të ndryshme lëshuar nga administrata tatimore të kërkuara në Kriteret e Përgjithshme të pranimit merret informacion mbi shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në vendet e origjinës.

Gjykojmë se ky kriter i AK është i ekzagjeruar pasi eksperiencia e kërkuar është e tepërt dhe ska asnjë bazë ligjore”.

III.11.6. Autoriteti kontraktues në informacionin dhe dokumentacionin e paraqitur pranë KPP-së ka argumentuar se: “Autoriteti kontraktues ka vendosur kriterin mbi punonjësit referuar Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (i ndryshuar), Neni 46, pika 1 gërma "b", neni 44, pika 1, si dhe në mbështetje të VKM-se Nr. 914 date 29.12.2014

"Per miratimin e rregullave tii prokurimit publik, Kreu III, Seksioni II, Neni 26 pika 8/b, ku per tii provuar kapacitetet teknike dhe profesionale kerkohet deshmi per fuqine punetore tii operatorit ekonomik pjesemarres nii procedure afatet kohore jane vendosur nga autoriteti kontraktues dhe jane ne perpjestim tii plate me vleren dhe objektin e kontrates.

III.11.7. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktues për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Është në të drejtën e autoritetit kontraktues të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin në fuqi duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik dhe ligjit për koncensionet dhe partneritetin publik privat.

III.11.8. Në rastin konkret, referuar edhe argumentimeve të autoritetit kontraktues, KPP gjykon se përcaktimi i këtij kriteri është në përputhje me objektin, natyrën dhe volumin e kësaj kontrate, e cila është një kontratë komplekse dhe kërkon kualifikime profesionale të stafit përgjegjës me qëllim zbatimin e kontratës në fjalë.

Kriteri i paraqitur për numrin e punonjësve është në proporcion me objektin dhe natyrën e kontratës si edhe me volumet e punës të kërkuara për këtë kontratë komplekse dhe me një fond limit të konsiderueshëm.

Gjithashtu, në lidhje me periudhën e përcaktuar përse i përket paraqitjes së listëpagesave, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se edhe vetë operatori ekonomik, pretendon thjesht unifikimin e saj dhe nuk pretendon se kjo periudhë është në kundërshtim me ligjin dhe rregullat në fuqi. Përcaktimi i autoritetit kontraktues që punonjësit (300 prej tyre) si edhe mjeku të vërtetohen që janë në listëpagesë për vitet 2014-2016, është një kriter në përputhje me objektin e procedurës konkurruese dhe është një element i domosdoshëm për të verifikuar kapacitetin e operatorëve ekonomikë në lidhje me stafin, pasi periudha 2 vjeçare e paraqitjes së listëpagesave është pikërisht për punonjësit si numër i përgjithshëm i një shoqërie. Nga ana tjetër përcaktimi i kriterit në listëpagesë për stafin drejtues për periudhën 2015-2016, është lehtësues dhe kërkohe për periudhën minimale më të afërt me datën e hapjes së procedurës konkurruese, në kushtet kur është kërkuar një numër i konsiderueshëm inxhinierësh, duke i krijuar mundësi çdo operatori ekonomik për të vërtetuar se disponon kapacitetet e duhura në lidhje me stafin teknik.

Akoma më tej, sqarojmë se dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti kontraktues si listëpagesat dhe formularët e deklaramit të pagesave, janë dokumentacion i vlefshëm dhe i domosdoshëm për autoritetin, mbi bazën e të cilit më pas do të bëhet verifikimi i plotësimit dhe disponimit të kapaciteteve të stafit.

Sa më sipër analizuar, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.12. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se kriteri [...] të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në listëpagesa për gjashtë muajt e fundit të paktën 30 punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT, duhet hequr. Gjithashtu kërkojmë të shtohet termi ekuivalent për dokumentat e paraqitura nga shoqëritë e huaja, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.12.1. Në dokumentat e koncensionit, Shtojca 9, pika 2.4. Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, pika 5.2 është përcaktuar kriteri si më poshtë:

• 5.1 Të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në listëpagesa për gjashtë muajt e fundit të paktën 30 punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT, ku nga këta të jenë të paktën:

- Grupi I- 7 (shtatë) punonjës
- Grupi II-10 (dhjetë) punonjës
- Grupi III- 9(nëntë) punonjës
- Grupi IV-3 (tre) punonjës
- Grupi V- 1 (një) punonjës
- (Per punonjësit e siperpermendur të paraqiten dëshmitë perkatëse të kualifikimit të sigurimit teknik)
- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 7 (shtatë) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë".

III.12.2. Në pikën 2 të nenit 22 të ligjit nr. 125/2013 “Për koncensionet dhe partneritetin publik privat”, përcaktohet shprehimisht: “Procedura për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private, me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, bëhet në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik”.

Në pikën 5, neni 23 po këtu, përcaktohet se: “Kriteret për dhënien e kontratës nuk duhet të jenë diskriminuese dhe duhet të jenë në përpjesëtim me objektin e koncesionit”.

Në pikën 7 të nenit 24 të ligjit 125/2013 përcaktohet: “Për të gjitha çështjet e njoftimit të kontratës, që nuk rregullohen nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, zbatohet ligji për prokurimin publik, në përputhje me rrethanat”.

III.12.3. Në nenin 26, pika 8 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktues kërkon:

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose
- b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.12.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “a” e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktues i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

- a) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktues në njoftimin e objektit të kontratës”.

III.12.5. Operatori ekonomik ankimues në ankesën e paraqitur pretendon se: [...] Sqarojmë se një kërkim i tillë është i tepërt pasi pikërisht për këtë qëllim nga ofertuesi kërkohen certifikata ISO. Është e paqartë se çfarë vlere provuese ka një kërkim i tillë për kapacitetin e shoqërisë?? Kërkojmë heqjen e këtij kriteri pasi më së paku është diskriminues. Çfarë vlere ka më shumë provuese një IQT e një saldatori se një certifikatë ISO e cila ka si objekti garantimin mbi standartet profesionale për saldim të shoqërisë? Siç vërehet edhe ky kriter ka për qëllim pengimin e konkurrencës së lirë.

[...]Në nenin 9 pika 1 gërma “a” të ligjit nr. 8734 datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike”, parashikohet se “Formimi i punëmarrësve” Punëdhënësi merr masat e nevojshme që: a) përdorimi i pajisjeve elektrike të bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, e lëshuar nga IPIE-ja ose nga komisioni i miratuar prej saj”. Në nenin 7 të ligjit nr. 13/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8734 datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike”, parashikohet se “Në nenin 9, shkronja “a” e pikës 1 ndryshohet si më poshtë: “a) Përdorimi i pajisjeve elektrike bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, të lëshuar nga një organ i akredituar certifikues personeli për fushën përkatëse”.

Gjithashtu në nenin 5 pika 1 gërma “c” të ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se: “Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit akrediton: c) organe certifikuese të personelit”. Konstatojmë se referuar ndryshimeve të lex specialis ligjit nr. 8734 datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike” me anë të ligjit nr. 13/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike”, parashikohet se Përdorimi i pajisjeve elektrike bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme të dokumentuar me dëshmi aftësie, të lëshuar nga një organ i akredituar certifikues personeli për fushën përkatëse”. Sa më sipër gjykojmë se kuadri ligjor në fuqi nuk parashikon mundësinë e certifikimit të punonjësve të subjekteve juridike pranë një organi shtetëror (ish Inspektoriati Qendror Teknik IQT) sot Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI).

Përse pikërisht ai numër punonjësish me grupet e mësipërme të kategorive? Përse duhen 30 punonjës me dëshmi aftësimi profesional për punime elektrike? Kemi të bëjmë me ndërtim civil dhe jo me rikonstruksion linjë elektrike. Gjithashtu kërkojmë të shtohet termi ekuivalent për dokumentat e paraqitura nga shoqëritë e huaja.

III.12.6. Autoriteti kontraktues në argumentin e tij parashton se: “Kriteri për punonjës të kualifikuar është vendosur në mbështetje të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", neni 40 ku citohet se:

"autoriteti kontraktues mund t'iu kërkojë personave juridike që paraqesin ofertën ose kërkesën për pjesëmarrje në raun dhe kualifikimet profesionale përkatese të personelit përgjegjës për zbatimin e kontratës.

Pra sa me sipër autoriteti kontraktues ska here asgjë më tepër vecse ka vënë kriteret për kualifikim në përputhje të plote me ligjin për prokurimin publik pra ka kërkuar punonjës të kualifikuar të domosdoshëm për realizimin e kontratës”.

III.12.7. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktues për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktues përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Është në të drejtën e autoritetit kontraktues të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin në fuqi duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik dhe ligjit për koncensionet dhe partneritetin publik privat.

III.12.8. Në rastin konkret, referuar edhe argumentimeve të autoritetit kontraktues, KPP gjykon se përcaktimi i këtij kriteri është në përputhje me objektin, natyrën dhe volumin e kësaj kontrate, e cila është një kontratë komplekse dhe kërkon kualifikime profesionale të stafit përgjegjës me qëllim zbatimin e kontratës në fjalë.

Kriteri i përcaktuar në lidhje me pajisjen e punonjësve me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT, është në proporcion me objektin dhe natyrën e kontratës si edhe me volumet e punës të kërkuara për këtë kontratë komplekse dhe me një fond limit të konsiderueshëm.

Sqarojmë se kjo procedurë konkurruese është një kontratë shumëvjeçare, e cila ka një volum punësh të konsiderueshëm ku përfshihen edhe punimet elektrike. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për menaxhimin dhe mirëpërdorimin e fondeve publike dhe si i tillë, është nën përgjegjësinë e tij edhe përcaktimi dhe vendosja e kriterëve dhe kërkesave të duhura në përputhje dhe proporcion me objektin dhe natyrën e kontratës.

Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se, për autoritetin kontraktues është e rëndësishme dhe e ka gjykuar si të domosdoshëm kërkesën për këtë kategori punonjësish të lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe në përpjesëtim me kontratën objekt shqyrtimi, referuar edhe studimit të

fizibilitetit, projekteve, specifikimeve teknike si dhe kërkesave të autoritetit kontraktues në dokumentat e koncensionit/ppp.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues se është e mjaftueshme kërkesa për certifikatat ISO nuk qëndron, pasi autoriteti kontraktues kërkon të bëjë verifikimin e disponimit të stafit teknik të duhur dhe të pajisur me kualifikimet e duhura e dëshmitë përkatëse lëshuar nga organe apo shoqëri të njohura për certifikimin e punonjësve të kualifikuar në një fushë të caktuar. KPP gjykon se përcaktimi i një kriteri të tillë është i domosdoshëm për verifikimin e kapaciteteve të stafit, e si rrjedhim pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.12.9. Në lidhje me pretendimin e ankimuesit përse i përket kategorive për të cilat është kërkuar dëshmia e lëshuar nga IQT, KPP arsyeton se në varësi të objektit të prokurimit, rëndësisë së ti, volumit të punëve, natyrës komplekse, autoriteti kontraktues përcakton edhe kriteret për vlerësim, ndërmjet të cilave është edhe kriteri për eksperiencën dhe kategorizimin e punonjësve sipas klasave përkatëse në lidhje me dëshminë e kualifikimit për profesionin përkatës, ndaj në rastin konkret përcaktimi i këtij kriteri nuk vjen në kundërshtim me përcaktimet ligjore në fuqi dhe është brenda objektit dhe natyrës së kontratës.

III.12.10. Referuar pretendimit të ankimuesit për dokumentacion ekuivalent, në kushtet kur kjo procedurë konkurruese është ndërkombëtare dhe është e hapur pjesëmarrja edhe e operatorëve të huaj, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktues në këtë rast, në kërkesën për dëshmitë e lëshuara nga IQT, e cila shërben për të vërtetuar kapacitetin e punonjësve të profesioneve të ndryshme, duhet të përcaktojë edhe kriterin për paraqitjen e dokumentacionit ekuivalent ose dokumenta të tjera provuese të aftësive përkatëse të punonjësve nga shteti i origjinës për shoqëritë e huaja, që provon këtë kualifikim.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues në lidhje me këtë kriter qëndron vetëm në lidhje me kërkesën për dokumentacion ekuivalent, kërkesë kjo që duhet të modifikohet nga autoriteti kontraktues.

III.13. Në lidhje me pretendimin nr. 13 dhe nr. 24 të operatorit ekonomik ankimues se kriteri *Licencë kodi III.7 A. Shërbime profesionale për projektme, shërbime profesionale për zbatime nuk është në përputhje dhe përpjesëtim me natyrën e objektit të kontratës pasi ndërtimi i këtij objekti do të kryhet mbi tokë truall referuar dhe sqarimeve të AK, si edhe kriteri Licencë III 1.A Lejë mjedisi tipi C. Pikë shërbimi për riparim automjetesh, nuk qëndron dhe duhet hequr*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.13.1. Në dokumentat e koncensionit/ppp, Shtojca 9, pika 2.4. Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, pikat 16 dhe 17, janë përcaktuar përkatësisht kriteret: *“Licence kodi III.7.A Shërbime profesionale për projektme, Shërbime profesionale për zbatime”*.

Licence III 1.A Lejë mjedisi tipi C . Pikë shërbimi për riparim automjetesh”.

III.13.2. Në pikën 2 të nenit 22 të ligjit nr. 125/2013 “Për koncensionet dhe partneritetin publik privat”, përcaktohet shprehimisht: *“Procedura për dhënien e koncesioneve/partneriteteve*

publike private, me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, bëhet në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik”.

Në pikën 5, neni 23 po këtu, përcaktohet se: “Kriteret për dhënien e kontratës nuk duhet të jenë diskriminuese dhe duhet të jenë në përpjesëtim me objektin e koncesionit”.

Në pikën 7 të nenit 24 të ligjit 125/2013 përcaktohet: “Për të gjitha çështjet e njoftimit të kontratës, që nuk rregullohen nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, zbatohet ligji për prokurimin publik, në përputhje me rrethanat”.

III.13.3. Në nenin 26, pika 8 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktues kërkon:

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose
- b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.13.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “a” e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktues i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

- a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;

III.13.5. Autoriteti kontraktues në informacionin dhe dokumentacionin e paraqitur argumenton se: “Në studimin për koncesionin e terminalit (ndërtim, operim dhe mirëmbajtje) është përcaktuar qartësisht se brenda terminalit do të afrohen edhe shërbirne të tjera shitesë për gjithë periudhën e koncesionit midis të cilave edhe pikë për riparimin e automjeteve prandaj AK e ka parë të arsyeshme që të marrë në konsideratë ofrimin e këtij shërbimi si një aktivitet i rëndësishëm po të kemi parasysh sasinë e madhe të autobuzeve dhe automjeteve që janë parashikuar të lëvizin brenda elitës në këtë terminal. Për pikën e shërbimit për riparim automjetesh AK ka vendosur si kriter vetëm që operatori ekonomik të ketë licencë për këtë aktivitet dhe nuk e ka kushtëzuar me kriteret e tjera si eksperiencë pune apo ushtrim aktiviteti në këtë fushë. Pra kriteri i vendosur është tejet minimal. Në këto kushte ky kriter i vendosur nuk është diskriminues por shumë i drejtë dhe kjo ankesë nuk qëndron”.

III.13.6. Në VKM nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, është përcaktuar: *Kategoria III.1 Për Ndikimin Në Mjedis*”

1. *Lejet mjedisore të përcaktuara në 34 pika 5 e ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar bëjnë pjesë në kategorinë III.1 të shtojcës së ligjit*

nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”

2. *Lejet e ndikimit në mjedis ndahen në tre nënkategori si vijon:*

- a) *“Leje e thjeshte mjedisore” me kodin III.1.A;*
- b) *“leje mjedisore” me kodin III.1.B;*
- c) *“leje e integruar mjedisore” me kodin III.1.C.*

1. *Veprimtaria e “shërbimeve të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me burimet mjedisore bazë” është kategoria III.7 e Shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.*

2. *Kategoria e kësaj veprimtarie specifikohet në dy nënkategori si vijon:*

- a) *“shërbime të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me pyjet apo kullotat”, me kodin III.7.A. [...]”.*

III.13.7. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, bazuar edhe në dokumentacionin e kësaj procedure konkurruese, studimin e fizibilitetit, specifikimet teknike, volumet e punës, kompleksitetin e kësaj kontrate shumëvjeçare, gjykon se vendosja e licencave të mësipërme është në proporcion me objektin dhe natyrën e kontratës. Nga verifikimi i shpenzimeve dhe kostove të parashikuara në studimin e fizibilitetit, konstatohet se zënë një vlerë të konsiderueshme zërat pemë, bar, gjelbërim etj. Në këtë kuadër, në përputhje edhe me vlerën e këtyre punëve autoriteti kontraktues ka gjykuar të nevojshme kërkesën për licencën e një kategorie të tillë.

Gjithashtu, autoriteti kontraktues informon se brenda terminalit do të ofrohen edhe shërbime të tjera shtesë për të gjithë kohëzgjatjen e koncensionit midis të cilave edhe pikë për riparimin e automjeteve ndaj ofrimi i këtij shërbimi është parë si një aktivitet i mundshëm dhe i rëndësishëm bazuar në sasinë e madhe të automjeteve që do të lëvizin brenda në këtë terminal. Në këto kushte, rrjedhimisht është parë e domosdoshme që operatori ekonomik i interesuar për të qenë pjesëmarrës në këtë procedurë konkurruese të jetë i pajisur me licencën përkatëse për aktivitetin shërbim për riparim automjesh.

Autoriteti kontraktor të saktësojë emërtesën e licencës III.7.A sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se përcaktimi i kategorive të licencave të mësipërme është në përputhje dhe proporcion me objektin dhe natyrën e kontratës ndaj rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.14. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se kriteri *Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj, kërkojmë të ndryshohet si më poshtë: Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse në përputhje me K.Civil ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj”, KPP vëren se:*

III.14.1. Në dokumentat e koncensionit/ppp, Shtojca 9, pika 18, gërma “c”, është përcaktuar kriteri “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (shtojca 8)

c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj”.

III.14.2. Në pikën 2 të nenit 22 të ligjit nr. 125/2013 “Për koncensionet dhe partneritetin publik privat”, përcaktohet shprehimisht: “Procedura për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private, me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, bëhet në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik”.

Në pikën 5, neni 23 po këtu, përcaktohet se: “Kriteret për dhënien e kontratës nuk duhet të jenë diskriminuese dhe duhet të jenë në përpjesëtim me objektin e koncesionit”.

Në pikën 7 të nenit 24 të ligjit 125/2013 përcaktohet: “Për të gjitha çështjet e njoftimit të kontratës, që nuk rregullohen nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, zbatohet ligji për prokurimin publik, në përputhje me rrethanat”.

III.14.3. Në nenin 26, pika 8 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktues kërkon:

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose
- b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.14.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “a” e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktues i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

- a) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktues në njoftimin e objektit të kontratës”.

III.14.5. Operatori ekonomik ankimes në ankesën e paraqitur pretendon se: “Referuar dispozitave të K. Civil kontrata ka fuqinë e ligjit për palët dhe kërkimi i AK që duhen noteriale është i pakuptimtë pasi K. Civil e ka rregulluar qartësisht se në cilat raste duhet kontrata noteriale. Një kontratë e vlefshme për periudhën e ndërtimit por që nuk noteriale nuk do të thotë se nuk ka fuqi ligjore apo nuk përmban të drejta dhe detyrime për palët. AK duhet të sqarojë se përse një kërkim i tillë është vendosur kur bie ndesh me ligjin dhe K.Civil.

Kërkojmë ndryshimin e këtij kriteri si më poshtë: Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse në përputhje me K.Civil ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj”.

III.14.6. Autoriteti kontraktues në informacionin dhe dokumentacionin e paraqitur, argumenton se: “Kodi civil nuk te detyron qe kontratat e qerases te cilat lidhen per me pak se 1 vit te lidhen para noterit por gjithashtu nuk ndalon qe kontrata te tilla te lidhen para noterit. Ne kushtet kur autoriteti kontraktues eshte perpara realizimit te nje objekti shume te madh dhe kompleks kerkon siguri dhe vertetesi te fakteve te paraqitura nga operatori ekonomik. *Pra autoriteti kontraktues kur kërkon noterizimin e kontratave nuk shkel asnjë dispozitë të kodit civil”.*

III.14.7. Në nenin 80 të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht:

Format e veprimit juridik

Neni 80

Veprimi juridik mund të kryhet me shkrim, me gojë dhe me çdo lloj shfaqje tjetër të padyshimtë të vullnetit.

Shkresa mund të jetë e thjeshtë ose akt notarial”.

Ndërsa në nenin 803 po këtu është përcaktuar shprehimisht: “Neni 803

[...].

Për sende të luajtshme të dhëna për pajisjen e një sendi të paluajtshëm, afati është baraz me kohëzgjatjen e qirasë së këtij të fundit.

Kontrata e qirasë, për një kohë më të gjatë se një vit, duhet bërë me shkresë.

III.14.8. Sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se Kodi Civil, për kontratat e qirasë për një kohë më të gjatë se një vit ka përcaktuar detyrimin që ky akt duhet bërë me shkresë, ndërkohë që po në këtë ligj, përcaktohet qartë se shkresa mund të jetë e thjeshtë ose akt notarial. Në rastin e kontratave për një periudhë më të vogël se një vit, kodi civil nuk përcakton detyrimin që kontrata e qirasë të lidhet para noterit, por nga ana tjetër as nuk e ndalon atë. Në këtë rast, forma e kontratës kërkohet për efekt provueshmërie, pra kontrata është e vlefshme por nuk mund të provohet me dëshmitarë. Referuar procedurës konkurruese, ky kriter për paraqitjen e kontratës së qirasë me akt notarial për mjetet është një element që shfaq një garanci dhe siguri për autoritetin kontraktues, në kushtet kur kemi të bëjmë me një kontratë me natyrë komplekse, dhe me një afat 35 vjeçar, ndaj është në të drejtë të autoritetit kontraktues që të kërkojë verifikimin e dokumentacionit që do të paraqesin operatorët ekonomikë, duke përcaktuar kriteret që janë në proporcion me natyrën dhe objektin e procedurës konkurruese.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.15. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik se kriteri *(e detyrueshme)* *Do të organizohet një vizitë në kantier deri në 10 ditë para zhvillimit të procedurës së Konkensionit të Partneritetit Publik Privat në mënyrë të tillë që operatorët ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t’u jepen informacione shitesë e shpjegime. Të gjitha kostot e operatorëve ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t’a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e*

mundur, është e paqartë nëse është kriter skualifikues ose pjesëmarrja në kantier?! , Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.15.1. Në dokumentat e koncensionit/ppp, Shtojca 9, pika 18, gërma “e”, është përcaktuar kriteri:

“(e detyrueshme) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në 10 ditë para zhvillimit të procedurës së Koncesionit të Partneritetit Publik Privat në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t’u jepen informacione shtesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t’a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.

Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni një shkresë pranë Drejtorisë së Prokurimit Bashkia Tiranë”.

III.15.2. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktues për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.15.3. Nga interpretimi i kriterit të mësipërm të kualifikimit dhe synimit të tij (ajo çka do të arrijë autoriteti kontraktues), Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se me anë të përcaktimit të mësipërm, synimi i autoritetit kontraktues për vizitën në kantier dhe për konfirmimin paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në vizitë, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me krijimin e një panorame të përgjithshme të operatorëve ekonomikë të interesuar mbi kushtet në të cilat ata do të zhvillojnë punimet objekt i kontratës së koncensionit, në rast të shpalljes fitues.

Gjithashtu, ashtu siç është theksuar edhe më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatorët ekonomikë kanë marrë informacion të hollësishëm dhe të mjaftueshëm mbi gjendjen aktuale të objektit, kjo me anë të informacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike si “*Studimi i fizibilitetit*”, “*Kriteret e vlerësimit*”, “*Projekt-zbatimi dhe specifikimet teknike*”.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se mos pjesëmarrja në takimin e organizuar, nuk mund të penalizojë operatorët ekonomikë pjesëmarrës gjatë vlerësimit të ofertave për të konsideruar të suksesshme ose jo ofertën e tyre ekonomike të dorëzuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi, por në rast të zbatimit të kontratës, këta të fundit nuk mund të ngrenë pretendime shtesë mbi mos pasjen dijeni për elementë konkretë të zbatimit në terren, për të cilat mund të ishin vënë në dijeni në momentin e organizimit të takimit në terren, duke qenë një herazi në përgjegjësinë e këtyre të fundit zbatimi me korrektësi i kontratës.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.16. Në lidhje me pretendimin nr. 16 dhe nr. 20 të operatorit ekonomik ankimues se për kriterin *Për kontratat e realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm: Deklaratë sipas shtojcës nr. 7, shoqëruar me:[...]; si edhe për kriterin Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2014 – Dhjetor 2016 shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, kërkohet të shtohet që “Për ofertuesit e huaj, në rast të moslëshimit të dokumentave si më lart, të paraqiten dokumenta ekuivalente me to”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.16.1. Në dokumentat e koncensionit/ppp, Shtojca 9 janë përcaktuar përkatësisht kriteret si më poshtë:

Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Deklaratën sipas shtojcës Nr.7, shoqëruar me:
2. Kontratë
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Certifikaten e marrjes ne dorezim.

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

6. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 7, shoqëruar me:
7. Kontrate;
8. Situacionin përfundimtar;
9. Akt kolaudimi objekti;
10. Certifikaten e marrjes ne dorezim te objektit;
11. Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.

List pagesat e punonjësve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Janar 2014 - Dhjetor 2016 shoqëruar me formularet e deklaramit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.

III.16.2. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktues për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.16.3. Për sa i përket kriterit për Deklaratën sipas Shtojcës nr. 7 dhe listëpagesave të punonjësve e formularëve të deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore e shëndetësore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në kushtet kur kjo procedurë konkurruese është ndërkombëtare dhe është e hapur pjesëmarrja edhe e operatorëve të huaj, autoriteti kontraktues

në këtë rast, për këto kërkesa duhet të përcaktojë që në rastin e moslëshimit të këtyre dokumentave përsa i përket ofertuesve të huaj, të paraqiten dokumenta ekuivalente me to.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron dhe autoriteti kontraktues duhet të bëjë modifikimin përkatës në lidhje me këto kërkesa.

III.17. Në lidhje me pretendimin nr. 17 dhe nr. 19 të operatorit ekonomik ankimues se për kriterin *Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2016, si edhe për kriterin “Për inxhinierët dhe stafin teknik drejtues dhe jo drejtues dokumentacioni si më poshtë:*

- i. Librezë pune (përkatëse)*
- ii. CV përkatëse*
- iii. Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)*
- iv. Diplomë*

kërkojmë të përcaktohet “Për ofertuesit e huaj, në rast të moslëshimit të ndonjë prej këtyre dokumentave në vendin e origjinës, të paraqitet dokument ekuivalent me të ose deklaratë me shkrim”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.17.1. Në dokumentat e koncensionit/ppp, Shtojca 9 janë përcaktuar përkatësisht kriteret si më poshtë:

Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2016;

[...], shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtem:

- i. Libreze pune (perkatese)*
- ii. CV perkatese*
- iii. Kontrate pune e vlefshme (përkatëse)*
- iv. Diplome*

III.17.2. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktues për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.17.3. Për sa i përket kriterit për taksat vendore si edhe dokumentacionit librezë pune, cv, kontratë pune, diplomë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në kushtet kur kjo procedurë konkurruese është ndërkombëtare dhe është e hapur pjesëmarrja edhe e operatorëve të huaj, autoriteti kontraktues, për këto kërkesa duhet të përcaktojë që në rastin e moslëshimit të këtyre dokumentave në vendin e origjinës, në rastin e ofertuesve të huaj, të paraqiten dokumenta ekuivalente me to ose deklaratë me shkrim.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron dhe autoriteti kontraktues duhet të bëjë modifikimin përkatës në lidhje me këto kërkesa.

III.18. Në lidhje me pretendimin nr. 18 të operatorit ekonomik ankimues se *kërkojmë të përcaktohet kriteri për vërtetimin e lëshuar nga OSHEE për detyrimet e energjisë elektrike, si edhe të përcaktohet “Për ofertuesit e huaj nëse ky dokument nuk lëshohet në vendin e origjinës të lëshohet një deklaratë me shkrim”*, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.18.1. Në dokumentat e koncensionit/ppp, konstatohet se nuk është përcaktuar asnjë kriter në lidhje me pagesën e detyrimeve të maturimit të energjisë elektrike.

III.18.2. Në pikën 2 të nenit 22 të ligjit nr. 125/2013 “Për koncensionet dhe partneritetin publik privat”, përcaktohet shprehimisht: *“Procedura për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private, me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, bëhet në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik”*.

Në pikën 5, neni 23 po këtu, përcaktohet se: *“Kriteret për dhënien e kontratës nuk duhet të jenë diskriminuese dhe duhet të jenë në përpjesëtim me objektin e koncesionit”*.

Në pikën 7 të nenit 24 të ligjit 125/2013 përcaktohet: *“Për të gjitha çështjet e njoftimit të kontratës, që nuk rregullohen nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, zbatohet ligji për prokurimin publik, në përputhje me rrethanat”*.

III.18.3. Në nenin 26, pika 7 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktues kërkon:*

Për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktues kërkon: [...]një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik”.

III.18.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “a” e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar parashikohet se: *“[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktues i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:*

III.18.5. Në kushtet kur në vendimin nr. 575, datë 10.07.2013 *“Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”*, nuk është përcaktuar një kriter i tillë, dhe për sa kohë që në pikën 2 të nenit 22 të ligjit nr. 125/2013 *“Për koncensionet dhe partneritetin publik privat”*, përcaktohet shprehimisht: *“Procedura për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private, me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, bëhet në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik”*, si edhe në pikën 5, neni 23 po këtu, përcaktohet se: *“Kriteret për dhënien e kontratës nuk duhet të jenë diskriminuese dhe duhet të jenë në përpjesëtim me objektin e koncesionit”*, Komisioni i Prokurimit Publik arsyeton t'i referohet legjislacionit për prokurimin publik, në të cilin është përcaktuar qartë që autoriteti

kontraktues kërkon vërtetimin për shlyerjen e energjisë elektrike, çka detyrimisht autoriteti kontraktues nuk mund të përjashtojë këtë detyrim ligjor të përcaktuar në bazën ligjore si më sipër cituar ndaj duhet të përcaktojë një kërkesë të tillë në dokumentat e koncensionit/ppp.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet në sqarimin se në këtë rast nuk jemi në kushtet kur ky i fundit nuk mund të shtojë apo të vendosë kritere të tjera shtesë duke marrë kështu kompetencat e autoritetit kontraktues, pasi pavarësisht se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktues të përcaktojë kriteret minimale kualifikuese në një procedurë konkurruese dhe në rast se këto të fundit (vetëm kriteret e shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkuara) nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, e rrjedhimisht, në këtë rast specifik kur kemi të bëjmë me përcaktime dhe detyrime ligjore për një kriter të veçantë dhe shumë të rëndësishëm për të cilin është ndërmarrë edhe një fushatë gjithëpërfshirëse, KPP duhet të përcaktojë që autoriteti kontraktues në dokumentat e koncensionit/ppp ka detyrimin të vendosë një kërkesë të tillë ligjore, dhe në rastet e moslëshimit në vendet e origjinës për ofertuesit e huaj, të përcaktohet paraqitja e një dokumenti vetëdeklarativ me shkrim.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron dhe autoriteti kontraktues duhet të bëjë modifikimin përkatës në lidhje me këto kërkesa.

III.19. Në lidhje me pretendimin nr. 21 të operatorit ekonomik ankimues se për kriterin *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) mjek ndërmarrjeje, kjo të vërtetohet me paraqitjen Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe Kontratës së punës së mjekut me operatorin ekonomik e vlefshme për periudhën e ndërtimit dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën dy vitet e fundit, përkatësisht periudhën Dhjetor 2014 – Dhjetor 2016. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë të paktën anëtari kryesor i bashkimit duhet të plotësojë këtë kusht të ketë 1 mjek ndërmarrjeje, kërkojmë që të specifikohet në DK/PPP se në rast të ofertuesve të huaj ky kriter rregullohet sipas legjislacionit në vendin e origjinës,* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.19.1. Në dokumentat e koncensionit/ppp, Shtojca 9, pika 2.4. Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, pika 5.2. është përcaktuar kriteri: *“Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1(nje) mjek ndërmarrjeje, kjo të vërtetohet me paraqitjen Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe Kontratës së Punës së mjekut me operatorin ekonomik e vlefshme për periudhën e ndërtimit dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën dy vitet e fundit, përkatësisht periudhën Dhjetor 2014- Dhjetor 2016. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, të paktën antari kryesues I bashkimit duhet të plotësojë këtë kusht të ketë 1 mjek ndërmarrjeje”.*

III.19.2. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktues për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera

fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.19.3. Për sa i përket kriterit për mjekun dhe dokumentacionit që duhet paraqitur për të, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në kushtet kur kjo procedurë konkurruese është ndërkombëtare dhe është e hapur pjesëmarrja edhe e operatorëve të huaj, autoriteti kontraktues në këtë rast, për këto kërkesa duhet të përcaktojë që në rastin e moslëshimit të këtyre dokumentave në vendin e origjinës, në rastin e ofertuesve të huaj, ky kriter të rregullohet sipas legjislacionit në vendin e origjinës ose të paraqiten dokumenta ekuivalente me to ose deklarata me shkrim.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron dhe autoriteti kontraktues duhet të bëjë modifikimin përkatës në lidhje me këtë kriter.

III.20. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se *kërkojmë heqjen e pragut minimal për t'u kualifikuar dhe saktësimin e tij me pragu minimal i pikëzimit*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.20.1. Në dokumentat e koncensionit/ppp, Shtojca 11 Kriteret e Vlerësimit, është përcaktuar si më poshtë:

Ofertat do të vlerësohen në baze të kriterëve të mëposhtme, dhe fitues do të konsiderohet ai ofertues që ka pike më tepër në baze të kriterëve të vlerësimit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të vlerësojë Ofertat Teknike dhe Financiare, në baze të kriterëve të mëposhtme:

Kriteret e vlerësimit janë si më poshtë:

Nr.	Kriteri	Rezultati Maks.	Pragu Min/ Rezult. Kalues
<i>TC1</i>	<i>Përputhshmëria me Kriteret Minimale Teknike</i>	<i>2</i>	<i>1</i>
<i>TC2</i>	<i>Korrektësia teknike dhe operacionale</i>	<i>34</i>	<i>20</i>
<i>TC3</i>	<i>Sistemet e informacionit</i>	<i>4</i>	<i>2</i>

<i>TC4</i>	<i>Pranueshmëria Mjedisore dhe Sociale</i>	<i>10</i>	
<i>TC4-1</i>	<i>- siguria e brendshme e zonës dhe ndërtesave</i>	<i>4</i>	
<i>TC4-2</i>	<i>- teknikat inovative në fushën e kursimit të energjisë dhe pajtueshmëria me standardet mjedisore</i>	<i>4</i>	
<i>TC4-3</i>	<i>- zvogëlimi i ndikimit mbi trafikun lokal gjatë aktiviteteve të ndërtimit</i>	<i>2</i>	
	<i>KRITERET TOTALE TEKNIKE</i>	<i>50</i>	
<i>FC1</i>	<i>KOHËZGJATJA E KONÇESIONIT</i>	<i>10</i>	
<i>FC2</i>	<i>TARIFA E KONÇESIONIT</i>	<i>10</i>	
<i>FC3</i>	<i>TARIFAT E TERMINALIT</i>	<i>10</i>	
<i>FC4</i>	<i>NDARJA E FITIMIT</i>	<i>10</i>	
	<i>KRITERET TOTALE FINANCIARE</i>	<i>40</i>	
<i>CTC1</i>	<i>AFATI I NDËRTIMIT</i>	<i>10</i>	
	<i>TOTALI</i>	<i>100</i>	

Gjithashtu në dokumentat e koncensionit janë përcaktuar edhe kriteret përkaëse teknike, ku rezulton si më poshtë:

KRITERET TEKNIKE

Kriteret e vlerësimit teknik, duke përfshirë rezultatet dhe pragjet minimale / rezultatet kaluese (kur është e përshtatshme) përshkruhen më poshtë. Vlerësimi do të kryhet nga Komiteti i Vlerësimit, i asistuar nga ekspertë specifikë për fushat kyçe, dhe do të marrë në konsideratë elementët e përshkruar më poshtë.

TC1: Pajtueshmëria me Kushtet Minimale Teknike - 2 pikë (pragu minimal / rezultat kalues - 1 pikë).

Çdo Ofertues duhet të respektojë kufizimet minimale teknike të përcaktuara në Kriteret Minimale Teknike (Shtojca 13 Specifikimet Teknike). Koncepti kryesor që do të mbahet është që këto propozime të cilat nuk përputhen me këto kërkesa themelore do të skualifikohen.

TC2: Korrektësia teknike dhe operationale - 34 pikë (pragu minimal / rezultat kalues- 20).

Korrektësia teknike dhe operationale do të vlerësohet në bazë të dizenjës së projektit, planit të biznesit, afatit të realizimit dhe cilësisë së shërbimeve dhe masave për të siguruar vazhdimësinë e tyre.

Dizajni i Projektit – përshatshmëria e arranzhimeve të projektit dhe karakteristikave të tij, cilësia e Raportit të Dizajnit Paraprak, kriteret e cilësisë që do të zbatohen.

Dizajni i Projektit duhet të përmbajë një Raport Dizajni Paraprak dhe një Raport mbi Efikasitetin Operacional;

Raporti i Dizajnit Paraprak duhet të japë një përshkrim të përgjithshëm teknik të ndërtimit dhe instalimeve dhe të përfshijë detaje mbi

- *Përshkrimin dhe specifikimin e materialeve që do të përdoren për të përfunduar ndërtesat dhe zonat e terminalit*
- *Instalimet për të rritur komoditetin e udhëtarëve si shkallë dhe ashensorë;*
- *Sistemet e propozuara të informacionit, për shembull për pagesat, sistemet e njohjes së numrit të kompjuterizuar të targave, sistemet për caktimin e automjeteve në hyrje për të arritur përdorimin më të mirë të vendeve të parkimit, sistemet për monitorimin e flukseve të trafikut dhe okupimin e vendeve të parkimit;*
- *Teknikat dhe zgjidhjet novatore për sistemin e ndriçimit (si të zakonshëm ashtu edhe për emergjencat) do të vlerësohen mbi bazën e qëndrueshmërisë së tyre teknike, plotësisë së mbulimit të propozuar brenda terminalit, konsumin e tyre të energjisë, rritjes së nivelit të sigurisë në lidhje me ndriçimin në raste emergjente, zbatimin e zgjidhjeve backup, zgjidhjet anti-panik në zonat me rrezik të lartë;*

Raporti mbi Eficientë Operacionale duhet të japë një përshkrim të përgjithshëm të operacioneve dhe të përfshijë detaje për:

- *Mekanizmin e Pagesave dhe propozimet mbi integrimin e faturimit të biletave për shërbime të ndryshme;*
- *Përmbajtja e Raportëve Mujore Operacionale që do të dorëzohen Bashkisë së Tiranës;*

Plani i Biznesit – Analiza e Kostos dhe e të Ardhurave dhe Vlerësimi i Kostove të Përsëritura, duke përfshirë një Plan Investimi, Deklaratën Fitim & Humbje, Pasqyrën e Fluksit të Parasë dhe analizën e ndjeshmërisë.

Programi i Zbatimit – Koha e lejuar për kontrollin në terren, projektin e detajuar, ekzekutimin e projektit të ndërtimit, duke përfshirë prodhimin, shpërndarjen dhe instalimin e pajisjeve teknike. Gjatësia e periudhës së ndërtimit dhe koha për fillimin e funksionimit të terminalit duhet të jetë në përputhje me periudhën e ofruar në ofertën financiare.

Cilësia e shërbimeve dhe masave për të siguruar vazhdimësinë e tyre - Ofertuesit duhet të dorëzojnë programet e Mirëmbajtjes së tyre Kryesore dhe të Mirëmbajtjes Specifike për instalimet e ndërtesave dhe ato teknike, si dhe të masave të tjera për të siguruar funksionimin e mirë të objekteve deri në skadimin e periudhës së Konkensionit. Raporti mbi cilësinë e shërbimeve duhet të tregojë disponueshmërinë e tyre të garantuar dhe treguesit relativë të performancës;

TC3: Sistemet e Informacionit - 4 pikë (pragu minimal/ rezultat kalues - 2 pikë).

Sistemet informative për udhëtarët në mbërritjen dhe nisjen e autobusëve dhe tramvajëve / trenave dhe për përdoruesit e vendit të parkimit në lidhje me disponueshmërinë dhe aksesin në parkim do të vlerësohen mbi bazën e qëndrueshmërisë së tyre teknike, plotësinë e informacionit të propozuar, përhapjen e paneleve informative brenda terminalit dhe disponueshmërinë e informacionit nëpërmjet internetit.

III.20.2. Operatori ekonomik ankimues në ankesën e tij pretendon se: “[...]Sa më sipër, rezulton se për N. TC1, TC2, TC3, përveçse është specifikuar pikët për secilën kategori, është vendosur dhe Pragu minimal i pikëve për kualifikim. Sqarojmë se hartimi i projektit duhet të kryhet nga ofertuesi bazuar në të dhënat dhe përcaktimet e AK. Vlerësimi i tyre është subjektiv në varësi të gjykimit të tyre, mbi pritshmëritë e tyre, por kurrsesi një vlerësim subjektiv nuk mund të përbëjë shkak për skualifikimin e ofertuesit.

Pretendimi jonë gjen mbështetje në ligjin 125/2013, neni 23 [...]

Sa më sipër, gjuajmë se ligjvënësi ka krijuar hapësirat e nevojshme ligjore për vlerësimin e projekteve por në asnjë rast gjykimi subjektiv të përbëjë shkak për përjashtimin e ofertave vetëm e vetëm pse ai nuk përmbush pritshmëritë e anëtarëve të Komisionit. Në këtë rast se atyre ju lind e drejta ta vlerësojnë atë me pikë minimale. Sa më sipër kërkojmë heqjen e pragut minimal për t’u kualifikuar dhe saktësimin e tij me prag minimal i pikëzimit.

III.20.3. Autoriteti kontraktues në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP-së argumenton se: “Ne lidhje me pretendimin e ankimuesit lidhur me kriteret e Vlerësimit perkatesisht me kriterin TC 1 "Perpuethshmeria me Kriteret Minimale Teknike, TC2 "korrektesia Teknike dhe Operacionale", TC3 "Sistemet e Informacionit" prapun minimal te pikeve te vendosura per keto tre kriteret sqarojme se:

AK ne vendosjen e kriterëve te vlerësimit ka vepruar ne perputhje te plote me ligjin Nr.125/2013 "Per Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat" (Indryshuar) neni 23 I cili saktësisht shprehet se:

Kriter Vlerësimi per dhenien e kontrates se koncesionit/partneritet public privat eshte oferta ekonomkisht me e favorshme, bazuar ne kriteret te ndryshme **te lidhura me objektin** e koncesionit/partneritetit public privat.

Komisioni duke u bazuar ne Ligjin e mesiperem si dhe ne kompleksitetin e kontrates se Koncesionit/Partneritetit Publik Privat e pa te arsyeshme te vendosi kriteret e vlerësimit si me poshte[...].

III.20.4. Në nenin 23 të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, është përcaktuar se: **Kriteret e vlerësimit për dhënien e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat.**

1. Kriter vlerësimi për dhënien e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat është oferta ekonomkisht më e favorshme, bazuar në kriteret të ndryshme, të lidhura me objektin e koncesionit /partneritetit publik privat në fjalë, që përfshijnë cilësinë, meritat teknike, karakteristikat estetike, funksionale e të mjedisit, kostot e drejtimit, kosto të efektivitetit, ofrimin e shërbimeve pas dorëzimit të produkteve dhe asistencën teknike, datën e dorëzimit dhe periudhën e dërgesës ose periudhën e përfundimit të punimeve, çmimin e shërbimit për përfituesit fundorë, shumën e tarifës së koncesionit’.

Sa më sipër, KPP gjykon se autoriteti kontraktues si organi përgjegjës për mirëpërdorimin e fondeve publike dhe zhvillimin e procedurave konform legjislacionit përkatës në fuqi, përcakton kërkesa dhe kritere në përputhje dhe përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës, volumin, zërat e punës etj. Në rastin konkret ashtu siç edhe autoriteti kontraktues informon që *ka vlerësuar që ka nevojë të ketë një prag kalues pra një prag minimal në mënyrë që të evitohen kompanitë jo serioze, të cilat nuk kanë kapacitetet e duhura për të përmbushur pritshmëritë e kapacitetet përkatëse në lidhje me këtë investim kaq të rëndësishëm*, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se përcaktimi i këtij kriteri është në përputhje me natyrën e kësaj kontrate shumëvjeçare dhe komplekse.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.21. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se kriteri [...] *Inxhinier Elektronik (3) të ndryshojë në Inxhinier Elektronik (1)*, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.21.1. Në dokumentat e koncensionit/ppp, Shtojca 9, pika 2.4. Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, është përcaktuar kriteri:

5. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë pjesë të stafit teknik të punësuar të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV dhe të figurojnë në listpagesa per periudhen Janar 2015-dhjetor 2016:

- *Inxhinier Ndertimi (4)*
- *Inxhinier Topograf (2)*
- *Inxhinier Elektrik (1)*
- *Inxhinier Elektronik(3)*
- *Inxhinier Mekanik (2)*
- *Inxhinier Mjedisi (1)*
- *Inxhinier Informatik (1)*
- *Inxhinier Hidroteknik (1)*



III.21.2. Operatori ekonomik ankimues pretendon në ankesën e paraqitur se: *“Autoriteti kontraktues në hartimin e kritereve të koncensionit/ppp bazohet në objektin e prokurimit dhe nevojën e stafit që kërkohet për realizimin me sukses të veprës.*

Vlerat dhe volumet e punimeve janë parashikuar nga AK e konkretisht në Studimin e Fizibilitetit si më poshtë:

Tabela -3 – Kostot e investimit për zgjidhjen 3 (vetëm ndërtimi)

Referuar kërimit të AK dhe vlerave të punimeve e gjejmë të pabazuar kërkimin e AK dhe jo në përpjesëtim të drejtë me zërat dhe volumet e punimeve kërkimin për:

- *Inxhinier Ndërtimi (4)*
- *Inxhinier Elektronik (3)*
- *Inxhinier Informatik (1)*

Në rastin e punimeve të inxhinierisë mjedisore AK ka kërkuar vetëm një inxhinier edhe pse volumi i punimeve zë afërsisht 3 milion euro punime ndërsa për një zë i cili zë më pak se 47.000 euro kërkon që ofertuesi të ketë 3 inxhinierë elektronikë.

Sa më sipër gjykojmë se kriteri i vendosur duhet ndryshuar si më poshtë:

- *Inxhinier Elektronik (1)*

III.21.3. Autoriteti kontraktues në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP-së, argumenton se: “[...]AK ka shpallur një procedurë tenderuese për koncension e cila nuk përfshin vetëm ndërtimin por përveç tij edhe operimin dhe mirëmbajtjen e një terminali të transportit publik. Për sa më sipër është e qartë se stafi i kërkuar në DSK/PPP është jo vetëm për ndërtimin por edhe për operimin dhe mirëmbajtjen. Stafi i kërkuar në DSK/PPP është shumë minimal po të kemi parasysh që kemi të bëjmë me një terminal transporti pasagjerësh me autobusë për Tiranën i cili do të mbulojë të gjithë transportin drejt veriut, veri – lindjes, perëndimit dhe jugut të Shqipërisë dhe që është parashikuar të ketë një kapacitet përpunimi prej rreth 3000 pasagjerësh dhe rreth 100 autobuza në orë. Menaxhimi, lëvizja, informimi dhe shërbimi brenda dhe jashtë zonës së terminalit për një numër të tillë pasagjerësh dhe autobusësh në orës është një detyrë shumë e ndërlikuar dhe delikate. Administrimi, menaxhimi dhe operimi i këtij fluksi lëvizjeje është parashikuar të jetë elektronik. Nga sa më sipër, është e qartë se inxhinierët elektronik të kërkuar janë të nevojshëm dhe të domosdoshëm për pjesën e ndërtimit të terminalit por edhe për mirëmbajtjen dhe operimin e tij duke qenë se kemi të bëjmë me një projekt 35 vjeçar i cili do të kryejë aktivitetin në një sipërfaqe prej 8 ha, ku do të ketë objekte komplekse dhe zona polifunkionale me shumëllojshmëri ambientesh (zona e terminalit zonë tregtare, zonat e parkimit, banka, shërbime, kafe, restorante, ashensorë, ambiente teknike, pikë riparimi autobusësh, pikë furnizimi me karburant etj.).

Argumenti i përdorur në ankesën është mbështetur vetëm në koston e ndërtimit pra vetëm për periudhën e ndërtimit e cila është shumë më e shkurtër në parashikimet tona (rreth 2-3 vjet), ndërkohë që koncensionin parashikohet të shtrihet për 35 vjet dhe për këtë arsye ai nuk qëndron.

Por edhe po të marrim vetëm periudhën e ndërtimit, vlera e cituar në ankesë dhe marrë për referencë (rreth 47.000 euro – dhoma teknike për kontrollin e pompave), është shumë e vogël dhe e gabuar pasi ai është aktiviteti minimal që do mbulojë elektronika. Vlera e vërtetë që kërkohet të investohet është shumë më e madhe dhe është e përfshirë në kostot e ndërtimit të terminalit dhe ambienteve të tjera të cilat sigurisht që përveç aktivitetit ndërtimor kanë përfshirë edhe instalimet, pajisjet dhe sistemet që duhen për funksionim të godinave, terminalit, shkallëve lëvizëse, ashensorë, parkingjeve të kontrollit të biletarisë (ticketing), impiantet e furnizimit dhe ndriçimit, kundra zjarrit etj). Inxhinierët elektronikë në fushën e ekspertizës së tyre janë përgjegjës për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve elektronike, sistemet me fibra optike, arkitekturën e rrjeteve dhe protokolleve të transmetimit të të dhënave, teknikat e përpunimit dhe transmetimit të sinjaleve multimediale, teknikave dixhitale dhe sistemeve ëireless, sistemeve satelitore dhe me rrjeta me sensorë, sistemeve të kontrollit dhe elektrik etj.

Referuar fushës së mbulimit së detyrave funksionale të inxhinierit elektronik për AK rezulton se duhet (sikurse në çdo terminal psh në terminalët e pasagjerëve të aeroporteve) minimalisht:

- *Një inxhinier për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të informimit publik brenda terminalit (tabelat elektronike të orareve të mbërritjes dhe nisjes së autobusëve dhe sistemet e tjera, skanerat e bagazheve, sistemet dedektuese të metaleve, akseset e hyrjes, checkin/checkout etj)*
- *Një inxhinier do të duhet për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e qendrës së kontrollit të gjithë terminalit (Control Center), sistemin e radiove (ato të komunikimeve, radarëve etj), sistemet e kamerave të sigurisë, sistemit të ajrimit etj.*
- *Një inxhinier për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të jashtëm dhe parkingjeve në gjithë ambientet e tjera të terminalit, sistemet e akses control (barrierat kufizuese të hyrjeve), sistemet e biletarisë (ticketing) të parkingut, sistemet e ndriçimit, sistemet e alarmit, sistemet kundra zjarrit, sistemin e kontrollit të furnizimit me energji etj.*

Në të gjitha rastet e mësipërme ne kemi konsideruar vetëm 1 turn, ndërkohë që puna në terminal do të kryhet me turne pasi ai do të jetë i hapur të paktën nga ora 5 e mëngjesit deri në orën 22.00.

Nga sa përmendëm del qartë se volumi i punës dhe vlera që do të mbulohet nga elektronika e cila kërkohet nga AK që të investohet nga koncesionari në këtë tender është shumë herë më e madhe se ajo që ka përmendur ankuesi dhe kriteri i vendosur për stafin e inxhinierëve elektronikë është më minimali.

Të gjitha sa përshkruarm më lart janë sqaruar në dokumentacionin e studimit të fisibilitetit të hartuar për këtë terminal dhe në dokumentat standarte të koncesionit/ppp të cilat i janë vënë në dispozicion çdo ofertuesi”.

III.21.4. Në pikën 2 të nenit 22 të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, përcaktohet shprehimisht: *“Procedura për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private, me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, bëhet në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik”.*

Në pikën 5, neni 23 po këtu, përcaktohet se: *“Kriteret për dhënien e kontratës nuk duhet të jenë diskriminuese dhe duhet të jenë në përpjesëtim me objektin e koncesionit”.*

Në pikën 7 të nenit 24 të ligjit 125/2013 përcaktohet: *“Për të gjitha çështjet e njoftimit të kontratës, që nuk rregullohen nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, zbatohet ligji për prokurimin publik, në përputhje me rrethanat”.*

III.21.5. Në nenin 26, pika 8 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktues kërkon:*

- a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

c) *dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën*”.

III.21.6. Në nenin 46, pika 1, gërma “a” e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktues i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

a) *aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktues në njoftimin e objektit të kontratës*”.

III.21.7. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktues për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Është në të drejtën e autoritetit kontraktues të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin në fuqi duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik dhe ligjit për koncensionet dhe partneritetin publik privat.

III.21.8. Në rastin konkret, referuar edhe argumentimeve të autoritetit kontraktues, KPP gjykon se përcaktimi i këtij kriteri është në përputhje me objektin, natyrën dhe volumin e kësaj kontrate, e cila është një kontratë komplekse dhe kërkon kualifikime profesionale të stafit përgjegjës me qëllim zbatimin e kontratës në fjalë.

Kriteri i paraqitur për numrin e inxhinierëve, referuar dokumentave të procedurës, studimit të fisibilitetit, bazuar edhe në arsyetimin e autoritetit kontraktues është në proporcion me objektin dhe natyrën e kontratës si edhe me volumet e punës të kërkuara për këtë kontratë komplekse dhe me një fond limit të konsiderueshëm.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.22. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se *Në APP është ngarkuar një kërkesë nga një shoqëri e cila ka kërkuar sqarime nga AK ku ndër të tjera e vë në dijeni se ka një mospërputhje midis dy dokumentave standarte, pra atij në gjuhën shqipe dhe atij në gjuhën angleze.*

Kërkesa për sqarim ka për qëllim vetëm informimin dhe sqarimin dhe jo ndryshimin e kriterëve të koncensionit/ppp. AK në shkelje flagrante të ligjit ka ndryshuar kriterin e përcaktuar në DK/PPP shqip dhe nuk ka respektuar detyrimin e tij ligjor për shtyrjen e datës së dorëzimit të ofertave.

Gjithashtu AK në përgjigje të kërkesës së kësaj shoqërie ka sqaruar se prevalon DK/PPP në gjuhën angleze.

Referuar Kushtetutës së Shqipërisë gjuha zyrtare është gjuha shqipe. Referuar të gjitha procedurave, praktikat e deritanishme në çdo rast prevalon gjuha shqipe. Në të kundërt për të mos patur probleme lidhur me situata që mund të krijohen kërkojmë heqjen e dokumentave të DK/PPP në gjuhën shqipe.

Konkretisht paqartësia shfaqet si më poshtë vijon:

Tek DK/PPP në shqip tek pikat e licencës kërkohet:

NS-8A (Konstruksione betoni arme të parafabrikuar, struktura metalike dhe druri)

Ndërkohë tek DSPK në anglisht

NS-8A Prefabricated reinforced concrete, metal and wood structure constructions

Tek DK/PPP është kërkuar NS-9-C, tek DSPK në anglisht nuk është kërkuar.

III.22.1. Autoriteti kontraktues në dokumentacionin e depozituar pranë KPP-së argumenton se: “AK në asnjë rast nuk është shprehur se prevalojnë kërkesat e DSK/PPP në gjuhën angleze. Në kërkesën për sqarim nga ana e AK është pranuar që midis dy DSK – ve në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, ka pasur lapsuse dhe mospërputhje gjatë përkthimit të materialit dhe AK thjesht ka sqaruar referuar kriterit konkret se cila gjuhë do merrej për bazë në përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës nga operatorët ekonomikë vetëm në rastet e lapsuseve të evidentuara (po të shikohet përgjigja në një rast i jemi referuar variantit anglisht dhe në një rast varianit shqip). AK nuk ka bërë asnjë ndryshim në dokumentat e koncensionit/ppp dhe për rrjedhojë nuk ka detyrim ligjor të zgjasë afatin e dorëzimit”.

III.22.2. Në sistemin e prokurimeve elektronike, nga ana e autoritetit kontraktues është publikuar dokumenti kthim përgjigje për kërkesën për sqarim të paraqitur nga një operator ekonomik, nga ku konstatohet se ka lapsuse si edhe ka disa saktësime dhe modifikime kriteresh duke përshtatur dhe unifikuar kriteret në dokumentacionin në gjuhën shqip me ato në dokumentacionin në gjuhën anglisht. Pavarësisht se saktësimet që ka bërë autoriteti kontraktues konsistojnë në modifikime të dokumentave të procedurës konkurruese, për të cilat duhet të ishte bërë edhe shtyrja përkatëse, për sa kohë që procedura është e pezulluar dhe qëllimi i operatorit ekonomik ankimues arrihet pasi ky i fundit do të bëjë modifikimet përkatëse sipas konstatimeve të përcaktuara në këtë vendim nga KPP, rrjedhimisht autoriteti kontraktues, duhet të bëjë edhe saktësimet, modifikimet dhe unifikimet e përcaktuara në shkresën e publikuar në SPE, si në dokumentacionin në gjuhën shqipe dhe atë angleze, duke i përcaktuar njësoj kriteret në të dyja gjuhët, me qëllim mos krijimin e një situata konfuze dhe të paqartë për operatorët ekonomikë gjatë përgatitjes së ofertave ashtu edhe komisioni përkatës gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatorët.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.23. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, se:

[...]Kërkojmë të saktësohet DSK kursi i këmbimit apo data e kursit të këmbimit në lidhje me konvertimin e të gjithë vlerave të kërkuara në Euro. Kjo pasi, drejtëpërdrejtë pengon dhe krijon paqartësi për subjektet që kanë partner ndërkombëtarë të cilët, monedhën e vendit të tyre e kanë në USD apo në monedha të tjera, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.23.1. Në nenin 20, pika 3 të ligjit 125/2013 parashikohet se: *“Vlera e parashikuar e partneritetit publik privat llogaritet sipas përcaktimeve në legjislacionin e prokurimit publik”*.

Në nenin 9 pika 4 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, parashikohet se:

“Autoriteit kontraktues, në rastet e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë mund të konvertojnë vlerën limit të kontratës me një monedhë ndërkombëtare të përzgjedhur prej tij sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën në të cilën dërgohet për publikim njoftimi i kontratës”.

Autoriteti kontraktues në dokumentacionin e paraqitur sqaron se:

“[...] në mbështetje të nenit 9, pika 4 e VKM nr. 914, datë 26.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktues ka bërë konvertimin e vlerës së përafërt të përlogaritur të koncensionit sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në ditën në të cilën dërgohet për publikim njoftimi i kontratës”.

Sa më sipër, autoriteit kontraktues ka bërë konvertimin përkatës të vlerës së procedurës konkurruese, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 125/2013, datë 25.04.2013 *“Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”*, i ndryshuar, VKM nr. 469, datë 16.06.2010 *“Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e shqyrtimit të ankesave ndaj procedurave të koncesionit apo të vendimeve për përjashtim nga këto procedura”*, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 27, datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”*, i ndryshuar, VKM nr. 184, datë 17.03.2010 *“Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “2 T” sh.p.k. për procedurën konkurruese “E hapur, mbi kufirin monetar”, me objekt: “Për Hartimin, Ndërtimin, Financimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Transferimin e Terminalit të Transportit Publik Tiranë”, me nr. REF-64927-12-30-2016, me vlerë totale të vlerësuar të projektit 2.093.070.602 lekë (pa TVSH) ose 15.477.857,31 Euro (pa përfshirë TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.02.2014, nga autoriteti kontraktues Bashkia Tiranë.
2. Autoriteti kontraktues të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktues, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “2 T” sh.p.k.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 71 Protokoli,
Datë 16.01.2014

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Leonard Gremshi	Hektor Balluku	Kleves Janku	Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha